



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 03.02.2021, ora 09:30

**Drejton mbledhjen:**

**Ramazan Gjuzi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Seancë dëgjimore me kandidatët për plotësimin e 3 vendeve vakante në KDRTSH.
2. Seancë dëgjimore me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
  - Ecuria e procesit të eliminimit të pasojave të tërmetit të 26 nëntorit 2019, në rindërtimin dhe ndërtimin e objekteve mësimore në sistemin e arsimit parauniversitar, si dhe në sistemin e arsimit të lartë;
  - Si po funksionon transporti i nxënësve dhe mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar.
  - Çështja e përjashtimit të të diplomuarve me master shkencor nga konkurrimi për mësues në shkollat publike.

**Marrin pjesë:**

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri dhe Erion Piciri.

**Mungojnë:**

Enada Kapllani, Amra Barova.

**Të ftuar:**

Ardita Reçi

Genç Tomço

Laureta Roshi

Mevlan Shanaj

Engjell Ndocaj

Krenar Hajdëri  
Lumtor Shkreli  
Rafaela Rica  
Suela Mino  
Petrit Ruka  
Arian Sukniqi  
Elvin Nuriu

## **HAPET MBLEDHJA**

**Ramazan Gjuzi** – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Siç jeni njoftuar, sot në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore me kandidatët për tri vendet vakante në KDRTSH-së për zëvendësimin e zotit Altin Shegani, opozitë, zotit Robert Rakiplari, opozitë dhe zotit Vladimir Grosha, pozitë.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, verifikojmë kuorumin. Prezentë janë: Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri dhe Erion Piciri. Mungojnë Enada Kapllani dhe Amra Barova.

Atëherë, kuorumi i nevojshëm për të vazhduar mbledhjen plotësohet.

Fillojmë me rendin e ditës, pra me seancën dëgjimore me kandidatët për anëtarë të KDRTSH-së. Sot kemi ftuar në dëgjesë 12 kandidatë, të cilët do të paraqesin platformën e tyre dhe do t'u përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

Zonja Ardita Reçi do të fillojë e para, më pas do të jenë zoti Genc Tomço, Laureta Roshi, Mevlan Shanaj, Engjell Ndocaj, Krenar Hajdëri, Arjan Sukniqi, Lumtor Shkreli, Elvin Nuriu, Rafaela Rica, Suela Mino dhe Petrit Ruka.

Paraprakisht ju bëj me dije të gjithë kandidatëve se secili prej tyre ka 7 minuta kohë për të bërë prezantimin, më pas do të vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve, nëse do të ketë.

Atëherë, fillojmë me kandidaten e parë.

Përshëndetje, zonja Ardita Reçi!

**Ardita Reçi** – Përshëndetjeje!

**Ramazan Gjuzi** – Mirë se keni ardhur!

Fjala për ju, zonja Reçi, por shkurtimisht, pasi CV-në tuaj e kemi. Pra, shkurtimisht na paraqit të dhënat tuaja për komisionin.

**Ardita Reçi** – Faleminderit që më dhatë mundësinë të jem sot pranë jush!

Unë jam Doktore e Shkencave të Komunikimit dhe lektore në gazetari dhe në Shkencat e Komunikimit që nga vitit 2008. Në universitetin e Shkodrës kam qenë pedagoge *full time* dhe më pas në universitetin “Bedër” në Tiranë. Gjithashtu, kam eksperiencë në universitetin e Durrësit dhe atë të Elbasanit, lektore në nivelin “Master” dhe “*Bachelor*” në profilet gazetari dhe shkenca komunikimi. Përvojën time profesionale e kam filluar që prej 20 vjetësh si gazetare në terren, ku e kam ushtruar këtë funksion në 4 prej medieve kryesore kombëtare, siç janë gazetat “Shekulli”, “Gazeta Shqiptare”, “*Top Channel*”, “*News 24*” dhe kam mbuluar kryesisht sektorin e drejtësisë. Pas studimeve universitare për gazetari, unë kam përfunduar edhe studimet universitare në drejtësi. Pra, kam eksperiencë në të dyja këto fusha dhe kjo është edhe shtesa kryesore që më bëri të aplikoj për anëtare të këtij këshilli të nderuar, duke pasur parasysh që kam një profil, i cili mund të ofrojë ekspertizë në të dyja fushat, si në drejtësi, ashtu edhe në gazetari dhe shkencat e komunikimit. Aktualisht punoj (*nuk dëgjohet*)... këtij institucioni publik kërkimor/shkencor. Mendoj se prezenca ime nuk do të bëjë gjë tjetër në Këshill, veçse do të ofrojë ekspertizën profesionale në të dyja fushat ku kam njohuri. Prej vitesh unë jam edhe aktiviste e të drejtave të njeriut me organizata të ndryshme që operojnë në këtë sektor. Po ashtu, kam bashkëpunuar edhe me shumë organizata kërkimore, kulturore për realizimin e projekteve.... Më duket se kam një problem me lidhjen.

A më dëgjoni?

**Mirela Kumbaro** – Po, dëgjoheni!

Vazhdoni, ju lutem!

**Ardita Reçi** – Mendoj se pranë Këshillit Drejtues të RTSH-së do të vazhdoj të jap më të mirën time, ashtu siç kam bërë në të gjitha angazhimet e mia të mëparshme, duke mos bërë kompromis me profesionin dhe me parimet etike të zbatimit të tij.

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Reçi!

Kush nga anëtarët e komisionit ka pyetje?

**Mirela Kumbaro** – Zoti kryetar, a dëgjohem?

**Ramazan Gjuzi** – Po, zonja Kumbaro!

**Mirela Kumbaro** – Faleminderit!

Zonja Reçi, a më dëgjoni?

**Ardita Reçi** – Po, ju dëgjoj.

**Mirela Kumbaro** – Në fakt, dua të di më specifikisht interesin tuaj të drejtpërdrejt pikërisht për këtë këshill. Ma merr mendja se kur keni vendosur të kandidoni, e keni parë më nga afër aktivitetin e këtij institucioni të rëndësishëm publik, apo jo?

**Ardita Reçi** – Po, patjetër!

**Ramazan Gjuzi** – Zonja Kumbaro, përsëriteni edhe një herë pyetjen.

**Mirela Kumbaro** – Atëherë, unë supozoj që ju me siguri, kur keni vendosur të kandidoni për Këshillin Drejtues të RTSH-së, duhet ta keni parë më nga afër edhe funksionimin e këtij institucioni. Unë dua të di se cili është interesi juaj i drejtpërdrejtë për të kandiduar? Çfarë mendoni ju se do të sillni specifikisht në këtë institucion të rëndësishëm publik, siç është RTSH-ja? Çfarë mendoni ju se do të ndryshoni? Çfarë mendoni ju se duhet të ndryshojë në mënyrën se si funksionon RTSH-ja nga pozitat e Këshillit Drejtues në raport me ...*(nuk dëgjohet)*?

**Ardita Reçi** – Faleminderit për pyetjet!

Unë, për fat të mirë, ndoshta edhe të keq, nuk jam as piktores, as skulptore dhe as nga ndonjë gjini tjetër e artit. Këtu përpara kam ligjin nr. 97/2013 dhe në nenin 102 të Këshillit Drejtues të RTSH-së ka disa aspekte profesionale, të cilat konkretisht mund të kenë nevojë për ndërhyrje apo ekspertizë të profesionistëve të shkencave të komunikimit, kryesisht të gazetarisë. Këtu do të ndalem në pikën 8, te kompetencat e parashikuara në nenin 102, që është miratimi i platformës, i strukturës organizative dhe strukturës programore të RTSH-së; në pikën 11, që është mbikëqyrja e paanshmërisë, objektivitetit dhe tërësia e informacionit dhe në pikën 13 ku thuhet se këshillon drejtorin e Përgjithshëm në lidhje me programet dhe ndihmon në caktimin e normave dhe të gjitha aspektet e tjera profesionale, të cilat flasin për mënyrën e

funksionimit të këtij domeni publik, i cili nuk është thjesht transmetues, por përçues i vlerave dhe i parimeve të shëndosha etike dhe profesionale të gazetarisë të publiku shqiptar.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Reçi!

**Ardita Reçi** – Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Atëherë, fjala për zotin Tomço.

Përshendetje, zoti Tomço!

**Genc Tomço** – Përshendetje të gjithëve!

Unë jam Genc Tomço, inxhinier elektronik, i specializuar në teknikën e televizionit. Arsyeja për të cilën unë kandidoj, kandidoj që prej vitit 2018, kur u shpallën vakancat, është sepse e gjithë jeta ime, i gjithë kontributi im, kualifikimet e shumta dhe eksperiencia e gjithë jetës është investuar në këtë institucion, ku kam mbuluar funksione të shumta, shpesh në pozicione drejtuesish, si drejtor teknik i Televizionit e të tjera. Unë kam marrë pjesë në të gjitha etapat e zhvillimit të Televizionit. Kam kryer kualifikime në televizionin francez TDF, në televizionin gjerman ZDF, në Mbretërinë e Bashkuar pranë BBC-së, pra shteti ka investuar shumë për personin tim.

Veprimtaria dhe kontributi im në RTSH-së ndodhet e përshkruar në CV-në që kam paraqitur, ku janë bashkangjitur edhe detajet e veprimtarisë sime 40-vjeçare në RTSH. Pra, unë kam dëshirën, vullnetin dhe energjinë e duhur për të vazhduar kontributin në një këndvështrim të ri. Praninë e një inxhinieri të specializuar në teknikën e televizionit në Këshillin Drejtues e konsideroj një risi që duhet të jetë e vazhdueshme, sepse teknika është një pjesë e rëndësishme e një institucioni publik, si RTSH-ja. Gjatë viteve të fundit jam njohur dhe jam përditësuar me teknologjinë, pajisjet dhe sistemin që përdor sot RTSH-ja për të siguruar shpërndarjen e sinjaleve dhe transmetimin në teknologjinë AC/HD. Natyrisht, nëse zgjidhem si anëtar në Këshillin Drejtues, do të njihem më hollësisht me teknikën, bazuar gjithnjë me mundësitë që mund të krijohen, duke përpiluar një program dhe duke ia paraqitur Këshillit Drejtues që në mbledhjet e para. Nga takimet me personelin teknik mund të njihem më nga afër me mbarëvajtjen e punëve teknike. Krahas kësaj, do të njihem më nga afër me ngritjen profesionale të personelit inxhiniero-teknik, kërkesat për ngritjen teknike gjithnjë në bashkërendim me drejtuesit e sektorit teknik të RTSH-së. Kjo do të bëjë që Këshilli Drejtues të jetë gjithnjë aktiv në drejtim të teknikës, ndërkohë do të bëjë të mundur që nëpërmjet takimeve dhe bisedave të programuara të dalin edhe problemet që kërkojnë zgjidhje sa më të shpejtë apo çështje të tjera, që lidhen edhe me teknikën, por që duhet të përshpejtohen. Këtu dua të përmend, për shembull, projektin për dixhitalizimin e materialeve të arkivit të RTSH-së, sidomos të materialeve që janë në pistë magnetike. Sipas meje, që jam marrë me dixhitalizimin e materialeve të Arkivit

Qendror të Filmit Shqiptar që prej 20 vjetësh, duke parë materialet e arkivit të RTSH-së në film 16 milimetra bardh e zi dhe me ngjyra, mendoj se për këtë kërkohet një studim më i hollësishëm për të përshtatur në program të dixhitalizimit, ndoshta edhe me faza, në mënyrë që ta shpëtojme këtë pasuri të madhe që ka RTSH-ja.

Nuk dua të zgjatem edhe për mungesë kohe, ndaj dua të theksoj se unë do të punoj me përkushtim në drejtim të realizimit të dëshirës së përbashkët të të gjithë Këshillit të ri Drejtues për të pasur një radiotelevizion që të përmbushë detyrimet statusore ndaj teleshikuesit shqiptar.

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Tomço!

Kush nga anëtarët e komisionit ka pyetje? Nuk ka.

Atëherë, vazhdojmë me kandidaten tjetër, zonjën Laureta Roshi.

Përshëndetje zonja Roshi!

Fjala për ju.

**Laureta Roshi** – Përshëndetje!

Në vijim të komunikimit, ju them faleminderit edhe për mundësinë e përballjes me kandidaturat pranë komisionit tuaj për një detyrë apo për një pozitë që nuk them se e kam synuar, por e kam dëshiruar dhe jam përpjekur që edhe edukimi im në vazhdim t'i përshtatet pikërisht transmetimit, komunikimit në interes të publiku. Duke respektuar edhe mediet audiovizive, si dhe duke parë nga afër edhe ndryshimet që e kanë ndodhur në RTSH, mendoj se jam një potencial i mirë, për arsye se jo vetëm kam punuar në RTSH për 15 vjet, në “Radio Tirana” dhe në Televizionin Publik brenda informacionit, kam qenë edhe përgjegjëse për informacionin nga e gjithë Shqipëria, pra nga studiot lokale. Unë shikoj që tashmë RTSH-ja ka një ndryshim dhe një transformim të fuqishëm, pasi transmeton i gjithi në *Hight definition*. Kjo do të thotë se ky investim i RTSH-së përkon me interesin tim të drejtpërdrejtë për të pasur jo vetëm një informacion të paanshëm, por edhe një paketë argëtuese dhe informuese për publikun. Duke pasur parasysh se anëtari i Këshillit Drejtues të RTSH-së mundëson mbështetjen e politikave në të mirë të publikut dhe të realizimit të deklaratës së qëllimit të RTSH-së, mendoj se përgatitja ime, kapaciteti im dhe ajo që kam dhënë deri tani në 25 vjet në gazetari, mendoj se e meritoj vëmendjen tuaj dhe shansin që të bëhem pjesë e vazhdimit të politikave për përmirësimin e transmetimeve të RTSH-së. Më është bërë shpesh pyetja pse vazhdoj të këmbëngul për Televizionin Publik. Jo vetëm që është zemra ime dhe gjithçka që kam investuar në profesionin e gazetarit, por mendoj se është dritarja e mbrojtur nga ligji në shërbim të publikut, në shërbim të shtresave në nevojë, në shërbim të realitetit shqiptar dhe në një ekuilibër informacioni.

Unë mendoj se detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së përkon shumë mirë me vijueshmërinë e ekipit edhe në skuadër dhe, sipas ligjit, kompetencat tona janë në një harmonizim me të gjithë anëtarët e Këshilli Drejtues, me të gjitha profesionet që aktualisht shikoj se ka regjisorë brenda kandidaturave që janë tashmë fituese dhe të miratuara nga parlamenti dhe mendoj se një zë nga gazetaria do t'i ofronte më shumë energji dhe një këndvështrim më pozitiv. Çfarë unë shikoj se duhet bërë mirë në grup nga Këshilli Drejtues dhe në vazhdim të deklaratës së qëllimit të RTSH-së dhe në vazhdim të gjithë investimeve që janë bërë, sepse gjatë vitit 2019 RTSH-ja ka arritur të ketë një sinjal 90%, ashtu siç e kërkon ligji. Zhvillimet në teknikën HD kanë sjellë edhe mundësinë e rifreskimit dhe forcimit të dy studiove analoge, që është Korça dhe Gjirokastra, të cilat kanë programet e tyre.

Ajo që është më e veçanta, është se këtë herë RTSH-ja, me transmetimet që ka, ka arritur të ketë gjysmën e financës që merr nga buxheti i shtetit, pra i ka krijuar si të ardhura.

Unë mendoj se prania ime brenda Këshillit Drejtues do të mundësojë në idetë dhe në programacion për të rritur projektet që do të prodhohen brenda RTSH-së, sepse nuk është vetëm objekti i lajmeve. Tani ne kemi kanale, që kanë rritur audiencën dhe që plotësojnë interesat e shtresave të ndryshme. Këto programe, natyrisht, kanë nevojë për më shumë projekte konkrete dhe prodhime të vetë RTSH-së, që të kenë markën “RTSH”.

Paralel me investimet që janë bërë edhe nga OSBE-ja në lidhje me RTSH-në dhe me forcimin e profesionalizmit të gazetarëve, mendoj se ka pasur përmirësime në linjën editoriale. Të gjitha këto harmonizojnë një veprimtari mbështetëse të Këshillit Drejtues të RTSH-së, paralel me bordin e administrimit dhe këshillin e ankesave.

Detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së nuk është e veçantë nga skuadra. Vetë ligji nr. 97 i vitit 2013 i përcakton qartë detyrat dhe kompetencat.

Unë ju siguroj që nuk kam asnjë konflikt interesi dhe kam një imazh të pastër. Unë kam qenë korrespondente e shumë televizioneve. Në respektim të kriterëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së, që kur jam përfshirë në garë për këtë pozitë, nuk jam angazhuar në asnjë projekt, që të mund të prek interesat e RTSH-së. Angazhimi më i fundit ka qenë programi “Mirëmëngjesi Shqipëri” me një kontratë përpara 3 vjetëve. Pra, jam përpjekur që të respektoj kornizën ligjore dhe çdo gjë që ligji përcakton qartë për anëtarin e Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Për kapacitetin individual, nuk dua që t'ju marr më shumë kohë për shkak se CV-ja ime është shumë e pasur. Grada “Master shkencor” në shkencat e komunikimit, në universitetin shtetëror, ka qenë një studim shkencor. Kam certifikimin evropian të psikoterapisë pozitive, duke menduar që ekuilibrat brenda transmetimeve dhe ekuilibrat brenda marrjes së vendimeve për funksionimin e RTSH-së janë paralel me objeksionin.

Sot RTSH-ja ka shtuar gamën e transmetimeve, kjo është një punë pozitive dhe unë ndihem jashtë skuadrës së RTSH-së, pas një përvoje shumë të mirë, prandaj dua të jem brenda politikëbërjes për një RTSH, e cila të jetë në funksion të informacionit të ekuilibruar dhe të transmetimit. Jam e hapur për pyetje.

**Fatjona Dhimitri** – Zoti kryetar, a mund të bëj një pyetje?

**Ramazan Gjuzi** – Po, fjala për ju.

**Fatjona Dhimitri** – Faleminderit!

Është hera e dytë që ky komision dëgjon prezantimin e zonjës Roshi. Unë mendoj se ky është prezantimi më dinjitoz nga kandidaturat që kemi dëgjuar, të paktën për aq kohë sa unë kam drejtuar atë komision dhe deri më sot.

Unë mund të them që prezenca e zonjës Roshi, duke marra parasysh prezantimin e sotëm, por edhe CV-në e saj, do t'i bënte nder RTSH-së.

Unë kam 2 pyetje për zonjën Roshi. Nëse ju, zonja Laureta, do të përzgjidheni si anëtare e Këshillit Drejtues i RTSH-së, nga do ta filloni punën? Cila është pika juaj e fortë në raport me emrat e tjerë në garë?

Zonja Roshi, ju jeni gazetare e hershme dhe aktiviste e të drejtave të njeriut, aq sa e shpalosni edhe në CV-në tuaj. Keni një eksperiencë 25-vjeçare si gazetare, çfarë do të bëni ju, nëse zgjidheni si anëtare e Këshillit Drejtues të RTSH-së, për përmirësimin e pozitës së gazetarëve, si dhe raportin me lirinë e mediave?

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Dhimitri!

Fjala për ju zonja Roshi.

**Laureta Roshi** – Si fillim do të mbështes të gjitha nismat e marra deri tani nga drejtori i Përgjithshëm, duke e nisur nga kanalet e transmetimit të drejtpërdrejtë, do të mbështesja fort politikat e një transmetimi më përfaqësues për të gjitha shtresat dhe forcimin e kapaciteteve prodhuese në RTSH. Pra, do të riktheja markën e RTSH-së me prodhime interesante, dokumentare, qoftë edhe duke fuqizuar kanalën e transmetimit të Radio Tiranës. Jam shumë egoiste kur them që kur dua të udhëtoj apo kur përfshihem në mjediset sociale, të kem afër imazhin e RTSH-së dhe transmetimin e Radio Tiranës.

Një mbështetje e ekuilibruar për të respektuar Kodin e Etikës dhe ligjin. Mendoj të mos flas më për vete. Shpresoj të kem marrë vlerësimin maksimal, siç e kam marrë nga organizatat e shoqërisë civile në këto vite për të gjithë kontributin tim për sa u takon shtresave në nevojë, por edhe një transmetimi në parametra profesionale.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Roshi!



A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Vazhdojmë me kandidatin tjetër.

Përshëndetje, zoti Shanaj!

Ju lutem bëni një prezantim të shkurtër, sepse materialin e kemi para.

Fjala për ju.

**Mevlan Shanaj** – Faleminderit për mundësinë!

Unë jam nga nostalgjikët e televizioneve, me autoritet krijues dhe duke e gjykuar në vite, mendoj se pjesa më e dobët ishte politizimi, ndërsa tani politizimi është plakur, prandaj nuk kemi më probleme. RTSH-ja mund të jetë një nga kanalet, i cili nuk është robëruar nga politika subjektive, ashtu siç ndodh shpeshherë me kanalet e tjera jopublike, por që janë kombëtare.

Duke u kthyer në histori, jo për nostalgji, por për të vërteta, televizioni në atë kohë, edhe pse ishte i vetmi, shkriu kinemanë, teatrin, operën, koncertet dhe rriti autoritetin e tij krijues. Ky komunikim më duket se ndër vite sikur u zbeh.

Tani, çfarë ndodhi me shumë personalitetet e atij televizioni, të cilët u krijuan me emra, që nga regjisorët e famshëm, që ende dëgjohen në kanalet e tjera, nuk janë në Televizion? Ku vajti rubrika e organizuar “Teatri në ekran”? Ku vajti rubrika e dokumentarëve? Ku vajtën koncertet ose rubrikat e tjera bashkohore, si: konkursi, pra spektaklet e përjavshme?

Me gjithë mundësitë e mëdha që ka sot Televizioni, se realisht ka një shtrirje shumë të madhe, me shumë kanale, më duket se është anashkaluar një arshivë e pasur, që ekziston në televizion dhe nuk e ka aspak vëmendjen, duke blerë aparatura, të cilat konvertojnë arkivin. Arkiva është e lashtë, 40-vjeçare. Kjo nuk do të thotë që do të bëjmë zbulime arkeologjike, por do të risjellim vlerat e artistëve, të cilët i dhanë emër të madh artit, skenës, ekranit, muzikës së kultivuar, muzikës së lehtë. Pikërisht, për këto gjëra, me autoritetin e profesionit që më ka karakterizuar mua dhe kolegët e mi, është e domosdoshme të trokasësh dhe të kthesh vëmendjen te ky televizion, i cili ishte pa dyshim mediumi më i fuqishëm në Shqipëri.

Tani jemi në fazën që televizioni ka shpëtuar, siç e theksova, nga politizimi, por duhet të rrisë autoritetin. Përse ndodh që figurat kryesore të politikës nuk i shikojmë më në ekranin e Televizionit kur flasim me 1 apo me nga 2 orë dhe shikojmë kanale të tjera? Pra, janë të njëjtët gazetarë. Aty ka filluar, po them, Blendi Fevziu, Eni Vasili dhe Sokol Balla, po përse ikën këta? Sepse Televizioni filloi të mos i shikojë me personalitet figurat e veta. Është koha që të trokasim dhe të kuptojmë se nuk ka televizion tjetër që mund ta konkurrojë RTSH-në, sepse ai është televizioni i publikut dhe publiku e do pjesën e tij, do shpirtin e tij, do nostalgjinë, do autoritetin. Nuk ka njeri që pranon të nëpërkëmbet dhe publiku nuk të fal kurrën e kurrës.

Prandaj me një menaxhim të vëmendshëm, me një akceptim të vlerave do të bëjmë për Televizion, atë që kërkojmë dhe atë që themi. Pra, është fitore, sepse ka shpëtuar nga politizimit. Ai televizion ku punoja unë ishte i doktrinuar, por bënte gjëra të mëdha. Ne kemi bërë filma si: “Udha e shkronjave”, “Plumba Perandorit”, “Agimet e stinës së madhe” e të tjera, të cilët u bënë në sajë të një pasioni. Nuk ishte vëmendja për televizion, sepse kishte Kinostudion në atë kohë, por pasioni i krijuesve më duket se mungon, pikërisht ngacmimi i dellit krijues dhe rritjes së personalitetit.

Dikur Ismail Kadare dhe Dhimitër Xhuvani punonin redaktorë në gazetë, por emrat e tyre vazhdojnë të citohen ende, se ishin redaktorë të tillë. Edhe në Televizionin Shqiptar, nuk po filloj nga vetja, por po them Albret Minga, Ylli Pepo, Vera Grabocka, Pali Kuke, Stefan Gaja janë emra, të cilët janë bërë të dashur dhe imponues për opinionin e publikut.

Nuk është se sot nuk ka, unë nuk e di politikën se si merren, por di të them që pasioni, analiza e çdo dite se çfarë u transmetua mbrëmë në mbledhje të shkurtra, përgjegjësia, evidentimi në mbledhjet javore, janë disa forma që nuk ishin të tepërta, por, përkundrazi, janë të domosdoshme. Ishte gara mes krijuesve, ishte vendosja e stimulit dhe e sedrës. Po them një kuriozitet, është e çuditshme, por në atë kohë kishte honorar kur vinte një bashkëpunëtor; sot në të gjitha kanalet e tjera, që quhen kombëtare, të gjithë bashkëpunëtorët shkojnë gratis. Përse RTSH-ja nuk e ruan autoritetin, jo për t’u paguar, por autoritetin e vet krijues? Është televizioni mëmë, nga i cili kanë lindur televizionet e tjera.

Unë e theksoj që kthimi i rubrikave të caktuara, të programuara për publikun, do t’i japin përsëri një vëmendje. Do të thuash që në këtë ditë, është e përcaktuar, do të ketë koncerte, konkurse, do të ketë teatër e filma, që janë prodhime shqiptare dhe, pse jo, edhe me komente. Tani jepen pa fund filma, por diskutojnë se kush i pa apo nuk i pa, por nëse do të organizoheshin rubrika të tilla se si u prodhuan, jo thjesht për nostalgji, por për vijueshmëri kulture. Kultura e një kombi nuk kalohet, lexon një libër dhe e flak, por ai libër stivohet në mëndje, kështu është edhe krijimtaria, edhe personaliteti i televizionit.

Unë kam mall, dhimbje dhe nostalgji për televizionin, por kjo nuk do të thotë që malli dhe dhimbja ime korrigjon diçka, atë e korrigjon një grup me mendësi bashkëkohore, me dije, me pasion, me evidentim, duke qëndruar dhe insistuar shumë te krijimtaria. Duhet të jenë grupet që ishin, siç kanë qenë departamenti i famshëm i filmit, i cili arriti të ishte si një kinostudio më vete. Është e çuditshme, por ne çdo gjë mundohemi ta nxijmë dhe ta zhbëjmë. Në atë kohë, unë kam përvojën time, isha shefi i sektorit të filmit, drejtori më thoshte: “Mevlan, ti je artist, je krijues dhe i di këto gjëra, unë nuk dua të përzihem”. Pra, kishte një pavarësi krijuese. Ne, sigurisht, kishim kontrollin dhe censurën tonë, dijet tona, u rritëm, u maturuam,

por këtë gjë duhet ta shikoj edhe tek televizioni sot. Unë dua të ndiej emra krijuesish, personalitete të cilët, më vjen keq, por nuk i di. Pra, të ketë një vëmendje ndaj punës krijuese.

Edhe diçka të fundit, duke e paragjykuar kohën, siç kemi 30 vjet që e anatemojmë, unë di që personeli i kuadrit shkonte në universitet dhe gjente studentët më të evidentuar, i piketonte dhe bënte kërkesë në institucionet përkatëse për t'i marrë ato. Unë dua të them që në kohën kur kam shkuar unë, kanë qenë 29 veta në televizion, por unë u përzgjedha, sepse pata fatin që erdhi dikush, pa rezultatet dhe më kërkoi. Po kështu ka ndodhur edhe me kolegët e mi te Fakulteti të Filologjisë dhe te shkolla e Gazetarisë. Pra, ishte vëmendja për ta përzgjedhur kuadrin me rezultatet konkrete. Këta njerëz pa dyshim derisa kishin rezultate në shkollë, do të kishin edhe ambicie në punë. Prandaj domosdoshmërisht ka të bëjë zgjedhja dhe organizimi i sektorëve. Por, po theksoj, kthimi mbrapa i blerjes së aparaturave për të parë arkivin e Televizionit, i cili është shumë, shumë i pasur. Unë në përvojën time kam bërë që në vitet '72 Tefta Tashkon apo Marie Krajën, apo Lasgush Poradecin, apo Avni Rustemin e të tjerë, pra figura që janë bërë me filma. Dhe ndaheshin preferencat. Petro Lati mori preferencën e figurave historike. Mevlan Shanaj mori preferencën e dokumentarëve artistikë. Vera Grabocka mori preferencën e spektakleve. Pra, gjetja e njerëzve të përshtatshëm për të krijuar, shumëzimin e krijimtarisë do ta rrisë autoritetin e Televizionit. Zëri im do të jetë i tillë, unë dua krijimtari për publikun dhe publiku të jetë në dialog të pandërprerë me televizionin.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Shanaj!

A ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Ulqin, fjala për ju.

**Musa Ulqini** – Faleminderit, zoti kryetar!

E kam të pamundur të mos them dy fjali, duke besuar që nuk shkel asnjë gjë që lidhet me procedurën dhe me etikën. Në vitin 1998 Kuvendi i Shqipërisë ngriti për herë të parë një grup pune për të hartuar ligjin e parë në historinë e medieve shqiptare për transmetuesit, mediet elektronike private dhe publike, dhe pjesë e atij grupi të punës ishte edhe zoti Mevlan Shanaj. Unë, si kryetar i grupit të punës, e kujtoj me shumë konsideratë këmbënguljen e zotit Mevlan Shanaj, që thelbësore në të gjithë mënyrën se si duhej të funksiononte RTSH-ja sipas drejtuesit public, ishte depolitizimi. Shpirti i tij liberal më bëri shumë përshtypje në atë kohë, bashkangjitur me dijen dhe me këmbënguljen për ta ndryshuar në këtë mënyrë atë transmetues. Edhe pas 23 vjetëve unë jam shumë i lumtur që një personalitet i tillë vjen me modesti dhe kërkon të jetë pjesë e këtij ndryshimi shumë të madh që po ndodh në RTSH.

Faleminderit!

**Mevlan Shanaj** – Kam rastin t'ju falënderoj, i nderuar zoti Ulqini! Faleminderit, për konsideratën!

Është reciproke ndjesia për ta zhvilluar Televizionin, të cilin e quajmë tonin. Nuk ka gjë në Shqipëri, që nuk është jona. Le të jetë çfarë do lloj kanali, ai është yni, sepse ai hyn në familjen tonë, te njerëzit tanë me mënyrën e vet. Televizioni ka influencë, është autoritar, nuk është si radio, që të lë të bësh punë të tjera. Ai është diktator, të ul në tavolinë që ta shikosh dhe ta dëgjosh. Pra, unë dua një diktaturë të një televizioni që ka autoritet krijues. Të bëjmë një televizion, që të na mbërthejë në karrige, me gjëra që na japin vlerë si komb. Ne jemi të varfër në shumë drejtime, por jemi shumë të pasur dhe të pakrahasueshëm në pasurinë më të madhe shpirtërore dhe kulturore të traditës. Dua që këto në televizionin tim publik, edhe ju që po më dëgjoni, nuk keni televizion tjetër më të dashur sesa kur shikoni historitë e njerëzve tanë, të vendit, të publikut, të artistëve. Si u bënë të famshëm këta artistë? Televizioni ua dha shumëzimin. Televizioni kishte rubrikën, kishte autoritetin e teatrit, të spektaklit të përjavshëm dhe të filmit. Këto nuk duhet t'i lëmë të rastësishme. Çdo gjë, që lihet rastësisht, mbetet rastësi. Rastësisht mund të fitosh, rastësisht mund të thyesh këmbët, mund të thyesh kokën. Pra, duhet një mundësi, sepse teknikisht, shikoj që ka mundësi; është vendosur struktura, ka shpëtuar nga politika, sepse është fitore e madhe të shpëtojë. Atëherë, çfarë i duhet? Duhet menaxhim me mend për të vjelë emocionet, krijimin e kulturës, të traditës, e cila është gjithëpërfshirëse në televizion. Televizioni është libër, kulturë, teatër, muzikë dhe film. Çfarë nuk gjen njeriu në mënyrë kaq komode, kaq të thjeshtë, nga një aparat i vogël! Por, duhen njerëzit, që të investojnë më shumë dashuri. Pasioni e mban gjallë krijuesin. Nëse nuk ka pasion, do të ketë probleme.

Unë besoj se ekziston një kthim i vëmendshëm, sepse duket sikur gjërat po kthjellohen, po sqarohen më mirë, nuk po mbetet diçka e turbullt, e cila është krijuar prej kaq vjetësh në imazhin e njeriut. Ne kemi mundësi, sepse edhe nga malet na vjen një ujë i pastër kristal. Në thellësi, është shpirti dinjitoz i kombit tonë, i cili, për të gjithë ne, pa slogane, pa patriotizëm, kur jemi larg, na dhimbset dhe derdhim lot.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Shanaj!

Kalojmë te kandidati tjetër, zoti Engjëll Ndocaj.

Përshëndetje, zoti Ndocaj!

**Engjëll Ndocaj** – Përshëndetje dhe punë të mbarë!

**Ramazan Gjuzi** – Fjala për ju.

Shkurtimisht, ju lutem!

**Engjëll Ndocaj** – Mirëdita dhe punë të mbarë komisionit tuaj!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit!

**Engjëll Ndocaj** – E kam parë gjithmonë anëtarin e Këshillit Drejtues të Radio-Televizionit Shqiptar si një person që mban mbi supë një detyrë të rëndësishme, shumë delikate

për mbarëvajtjen dhe përgjegjësitë që ka institucioni ...*(nuk dëgjohet)*... pak a shumë edhe ndonjë koleg, si Mevlani.

Unë e quaj “institucion i vjetër”, sepse, pas 40 vjetësh pune në Televizion, pasi tani kam dalë në pension, ndihem ende pjesë e tij dhe me plot energji.

Gjatë gjithë kësaj periudhe mbingarkese që kam pasur me përgjegjësi, kam një përvojë të gjithanshme si krijues, duke filluar si gazetar, skenarist, regjisor, drejtues televizioni dhe, në fund, drejtues i prodhimit. Domethënë, e ndiej veten më ndryshe nga kandidatët e tjerë. Nuk po them, as më i mirë, as më i keq, por përvoja ime përbën një diferencë. Kjo më ka bërë të mendohem gjatë para se të kërkoj ...*(nuk dëgjohet)*...

Më tepër më kanë nxitur disa ide të miat, të qarta dhe të realizueshme, të cilat i bazoj në kompetencat që ka Këshilli Drejtues.

Do ta filloja me një pikë shumë të rëndësishme, të cilën unë e mbaj mend që kur është krijuar Këshilli Drejtues, në 40 vjetët e punës sime, me raportin e secilit nga anëtarët e Këshillit Drejtues me institucionin. Kur them “me institucionin”, e kam fjalën me çdo punonjës. Më konkretisht, do të propozoja që secili nga anëtarët e Këshillit Drejtues, në bazë të profesionit, sepse kuptohet, nuk janë të gjithë artistë, gazetarë, siç ka ndodhur gjithmonë, në mbledhjen e parë të marrë përsipër një sektor apo një departament të Radiotelevizionit Shqiptar, për të qenë sa më afër punonjësve. Këtë e them nga përvoja ime, sepse kam parë gjithmonë që midis Këshillit Drejtues, secilit anëtar dhe institucionit, në sektorë të caktuar, ka një distancë, ndoshta edhe mosnjohje, e cila krijohet pikërisht nga fakti që janë larg. Do të ishte mirë që secili nga anëtarët e Këshillit Drejtues, për shembull, ai, që është artist, të merrej me pjesën artistike, me kanalet artistike të televizionit; një tjetër, që është ekonomist, të merrej direkt me të, sepse ...

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Ndocaj!

A keni mbaruar?

**Engjëll Ndocaj** – Mendova se u ndërpre.

**Ramazan Gjuzi** – Nuk dëgjoheni.

Rregulloni mikrofonin!

**Engjëll Ndocaj** – Dëgjohem?

**Ramazan Gjuzi** - Po, mund të vazhdoni.

**Engjëll Ndocaj** – Këshilli Drejtues duhet të ketë lidhje me çdo hall, gjë që i ka munguar deri tani. Do të ishte shumë me vlerë prania e secilit prej anëtarëve të Këshillit Drejtues një herë në javë te sektorët, pranë punonjësve. Si mund të diskutosh në një mbledhje, të ngresh dorën për një projekt, apo diçka tjetër, kur ti projektin e ke vetëm në letër, nuk i njej njerëzit, që do të punojnë me atë projekt. Mendoj se kjo distancë duhet të evitohet...

Diçka tjetër shumë e rëndësishme, që e kam jetuar sidomos në këta vjetët e fundit, është se ne kemi nevojë për njerëz që dinë të shkruajnë, njerëz që kanë nevojë për aftësi krijuese, njerëz me talent për të ushqyer, së pari, njësinë e programeve me tematikë dhe skenarë të mirëfilltë. Pra, një bërthamë krijuese, e përbërë fillimisht, do të thosha unë, dhe ky është propozim nga një ideator dhe një skenarist, të cilët mund të jenë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Radiotelevizionit. Nëse flasim për të bërë atë që na mungon, për shembull, një spektakël, kush do ta shkruajë? Nëse flasim për një *talk show*, kush do ta shkruajë? Brezi i vjetër i krijuesve ka ikur, janë të gjithë në pension dhe tani janë disa të rinj.

Për sa i përket kësaj, kam edhe diçka tjetër.

Të vijmë në një pikë që është detyrë e Këshillit Drejtues, marrja në punë e punonjësve, përcaktimi i mënyrës se si merren në punë. Për arsimin profesional të punonjësve, marrjen në punë dhe ngritjen e tyre, do të propozoja që Radiotelevizioni Shqiptar të hapte një kurs specializimi për të ngritur këtë nivel. Gazetarët që vijnë në Televizion janë nga Gjuhë-Letërsia, nga Gazetaria ose nga një degë tjetër, dhe mendojnë se kanë talent, por nuk mjafton talenti dhe aftësia. Televizioni ka nevojë ta njohësh në thellësi, ndaj do të ishte mirë të hapej një kurs dhe të mbulohet pikërisht nga anëtarët e Këshillit Drejtues, ku secili prej tyre të ishte edhe një lektor, sipas profesionit të vet.

Ne kemi një përvojë shumë të mirë të vitit 1981, kur unë kam filluar punë. Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar, zoti Marash Hajati, hapi kurs specializimi për gazetari televizive. Ne ende sot nuk kemi harruar asgjë, të paktën flas për vete, nga ato që kemi mësuar në atë kurs, nga provimet që kemi dhënë, ku të gjitha na kanë hyrë në punë në jetën profesionale. Gazetarët që vijnë kanë nevojë për një specializim, i cili nuk ka problem të madh për t'u bërë, sepse bëhet brenda institucionit, për 6 muaj ose 1 vit.

Gjithashtu, do të ishte mirë që edhe ata, të cilët mbarojnë fakultetin, të ishin kandidatë të caktuar, që temën e diplomës ta mbrojnë pranë Televizionit dhe atëherë ne vlerësojmë njerëzit që do të zëvendësojnë të vjetrit dhe televizioni të vazhdojë të ketë një nivel, të mos ketë ulje-ngritje në nivelin krijues nga disa që ikin dhe disa që vijnë, sepse mbetet gjithmonë gropë dhe kjo do të pasqyrohet në programe.

Në mbledhjet e Këshillit Drejtues, kur diskutohen projekte të mëdha, kam qenë disa herë gjatë viteve të mia, dhe është mirë *...(nuk dëgjohet)...* jo vetëm Këshilli Drejtues, me letrat përpara të projektit, fjala vjen, festivali i Vitit të Ri, e të tjera, por është mirë që të pranishëm në Këshillin Drejtues, në mbledhje të tilla, ku aprovohen projekte, të ketë edhe autorë, duke filluar nga skenaristi, regjisori, ekonomisti e të tjerë. Secili nga anëtarët duhet të bindet nga

njerëzit që do ta bëjnë këtë program, nëse duhet të ngrerë dorën për po, apo të mos e ngrerë dorën. Dora nuk ngrihet vetëm me një të lexuar të atij projekti, që anëtari e ka përpara në letër.

Një pikë tjetër shumë e rëndësishme në institucion, është rinovimi i librit të pagesave dhe honorarëve. Ky libër është bërë nga unë në vitin 2004. E kam bërë unë dhe është gati edhe projekti për tjetrin. Domethënë, ky libër pret aprovimin e Drejtorisë së Përgjithshme ose të Këshillit Drejtues. Nuk mund të vazhdojmë me libër honorarësh të vjetër, të cilët janë në kontradiktë me kohën e sotme dhe me honorarët, që krijuesit apo bashkëpunëtorët marrin në televizione të tjera, sepse kështu largohen njerëzit.

Nuk ngelet jashtë ideve të mia edhe diçka tjetër. Këshilli Drejtues duhet ta ngrejë zërin fort në Kuvend. Unë kam përshtypjen se në gjithë këta vjet që kanë kaluar, kemi diçka që ka mbetur në dorën e Këshillit Drejtues, dhe është pikërisht digjitalizimi i arkivimit. Digjitalizimi i arkivit është bërë, por nuk janë digjitalizuar programet. 11 mijë kilometër kanë ngelur film, që kur kemi filluar me filmin, derisa kemi mbaruar, në vitin 1992.

Gjithashtu, kemi mijëra kasete dhe botime me shirit manjetik, që janë një nga thesaret që ka Televizioni, institucioni ynë, të cilat duhen shpëtuar patjetër. Këtë gjë nuk e bën dot vetëm drejtori i Përgjithshëm, por duhet ta ngrejë zërin fort Këshilli Drejtues. Kjo është një nga detyrat që mund të ketë secili nga anëtarët e Këshillit Drejtues për të bërë këtë punë. Nuk mund ta lëmë arkivin e Televizionit Shqiptar të flejë ...*(nuk dëgjohet)*.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Ndocaj!

Kush ka pyetje nga anëtarët e komisionit?

Nuk ka.

Faleminderit!

**Engjëll Ndocaj** – Ju falënderoj edhe unë!

Ju uroj punë të mbarë jo vetëm juve, por edhe Këshillit Drejtues!

**Ramazan Gjuzi** - Kalojmë te kandidati tjetër, zoti Krenar Hajdëri, i cili ndodhet në komision.

Fjala për ju, zoti Hajdëri.

**Krenar Hajdëri** – Faleminderit!

Përshëndetje, të gjithëve!

**Ramazan Gjuzi** – Përshëndetje!

**Krenar Hajdëri** – Për herë të parë unë po ndërmarr diçka të tillë, me dëshirën për të qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. Nuk kam qenë asnjëherë anëtar i bordeve të ndryshme. Pra, po e bëj për herë të parë këtë gjë.

Personalisht, e mora iniciativën për të qenë pjesë e këtij këshilli të nderuar, nisur nga fakti se gjykoj që tashmë, pas gjithë këtyre viteve punë, e ndiej veten në lartësinë e një detyre të tillë.

Fjalën time për komisionin tuaj të nderuar, do ta nisja me një premisë. Është disi e vështirë të flasësh për një institucion, si Radiotelevizioni Publik Shqiptar, pa e njohur atë dhe problematikat e tij nga brenda. Dëgjova parafolësit, të cilët kanë punuar prej vitesh në këtë institucion dhe e njohin mjaft mirë atë në problematikat që ka. Megjithatë, në këtë ndërhyrje, edhe unë do të mundohem të shfaq disa mendime personale, nisur nga ajo që kam parë dhe kam ndjekur për evolucionin e këtij televizioni, por thjesht nga pozitat e një shikuesi.

Fillimisht, do të thosha se Radiotelevizioni Shqiptar është një aset me vlerë kombëtare. Ai ka historikun e vet që nga periudha kur ishte i vetmi mjet informimi për publikun shqiptar, por edhe gjatë këtyre 30 vjetëve të zhvillimit në fushën e konkurrencës me ente të tjera informimi, të lindura dhe të zhvilluara gjatë periudhës së demokracisë.

Sigurisht, në kushtet e reja të zhvilluara, Televizionit dhe Radios publike shqiptare i duhej të përshtatej me kushtet e reja, sidomos në drejtim të konkurrencës. Sa e ka arritur ai atë? Do të thosha se gjatë këtyre viteve ka pasur arritje, por me mundësitë ekzistuese që ka pasur ky televizion publik, këto arritje nuk janë edhe aq mbresëlënëse.

Më poshtë po rreshtoj disa problematika, të nxitura nga vetë përvoja ime si shikues i këtij institucioni informimi publik, por nisur edhe nga disa krahasime me televizione të tjera me shikueshmëri të lartë.

Zhvillimi i RTSH-së gjatë viteve të fundit, sidomos me futjen e sistemit digjital në transmetim dhe në të gjitha kanalet e tij, në përshtypjen time është bërë pa një plan strategjik të mirëfilltë, pa një synim të qartë se ku kërkohet të arrihet. Procesi i digjitalizimit është parë thjesht si një teknikë, pa pasur parasysh se ky proces duhet të ketë synim rritjen e tij cilësore në pikëpamjen e shikueshmërisë dhe në komercializimin e produkteve të tij. Në mbështetje të kësaj ideje, mund të them se produksionet televizive në RadioTelevizionin Shqiptar janë më tepër të një karakteri sasior sesa cilësor. Sot, të jesh një televizion publik me shikueshmëri të lartë dhe konkurrent i televizioneve kryesore private, nuk do të thotë të rritësh në mënyrë artificiale numrin e kanaleve apo të emisioneve televizive, por të synosh të krijosh produksione televizive cilësore, edhe pse ato mund të jenë me një numër më të paktë, ku elementet e krijimit të produktit, si: studio, produksioni, tematika, modelimi, faqosja grafike dhe lancimi promociional të jenë të kombinuara dhe cilësore.

Në Radiotelevizionin Shqiptar vihet re një numër emisionesh shpesh herë me të njëjtën tematikë, në kanale të ndryshme, siç janë, për shembull, emisionet e mëngjesit, dy të tillë, në



RTSH 1 dhe në RTSH 2, në të njëjtën orë; emisione kulturore në një numër të konsiderueshëm, ku moderatorët ndërrohen sipas ditëve, me tematika të njëjta, të mërzitshme dhe pa frymë bashkëkohore televizive. Emisionet nuk duhen bërë për të zënë me punë disa moderatorë apo autorë, por me një koncept të qartë tematik, me mision social, të etiketuar për target grupe të ndryshme.

Kjo gjë vlen edhe për emisionet në radio, ku mund të veçohen vetëm disa emisione për ndjekje nga një numër i konsiderueshëm i publikut.

Për sa më sipër, vërtetohet më së miri nga *feedback*-u i emisioneve në medien *online*, *youtube* e të tjera, të cilat kanë një numër shumë të vogël shikimesh.

Një problem tjetër evident me Radiotelevizionin Shqiptar, që është shitur si arritje, është filmi pa koncept programativ dhe në mungesë të një arkive të mjaftueshme për numrin e kanaleve televizive.

Televizionet publike, nga ajo që unë kam parë dhe jam munduar të shfletoj gjatë kësaj periudhë, në Europë, si: RAI, France Television apo ZTF-ja në Gjermani kanë ndjekur një logjikë, ata kanë forcuar dhe evidentuar si kanal kryesor të tyre kanalën e tyre të parë, pra ZDF-ja, në rastin konkret për Gjermaninë, RAI-1 dhe kanali Francë 2, duke forcuar fillimisht brendin korporativ në përmbajtje, teknologji dhe promovim në betejën audiovizuale me RTL-grup në Gjermani, Mediaset në Itali dhe TF1 në Francë për të kaluar vetëm më vonë në shtimin numerik të kanaleve të tjera në platformë.

RTSH-ja sot duhet të ketë për qëllim që kanalën autentik dhe kryesor të saj, RTSH 1, ta kthejë në kanalën më të ndjekur të të gjithë shqiptarëve, pasi mundësitë i ka, duke konkurruar dhe lënë pas, pse jo “Top Channel”-in, “Klan”-in ose “Vizion Plus”-in. Natyrisht, platforma e RTSH-së, për mendimin tim, duhet të ruajë disa kanale tashmë të krijuara, si: RTSH 2, RTSH 24, RTSH Kuvendi, ose RTSH- Sport, por të riformatojë kanale të tilla, si: RTSH 3, RTSH Film, RTSH Muzikë, RTSH Plus, RTSH Agro, e të tjera, një numër i pafund kanalesh televizive, të cilat nuk mbështeten me materialet e duhura. Pra nga 14 kanale, që janë sot, mund të jenë 6 ose 7 të tilla, por të saktë dhe të ndjekur.

Problem shumë serioz është investimi në teknologjinë e transmetimit në RTSH. Personalisht kam qenë pjesë emisionesh televizive në RTSH, ku jam ftuar për diskutime të ndryshme. Ambientet e transmetimit kanë mbetur thuajse si para 30 vjetësh, sidomos në drejtim të studiove televizive. Po të shohim konceptin skenografik të studiove sot në RTSH, ato mbeten anakronike, të një stili dhe koncepti të vjetër, me një ndriçim shumë problematik, gjë që ndikon negativisht në kontentin e emisioneve dhe në imazhin në tërësi. Sot një televizion i madh nuk

mund të konceptohet dot pa një studio virtuale. Pra, gjithë ky Televizion publik shqiptar nuk ka një studio virtuale, e cila ta bëjë atë të barabartë me simotrat e tij në vendet e tjera.

RTSH-ja sot ka nevojë të investojë, sidomos në burime njerëzore, profesionale sa u përket regjisorëve, skenografëve, redaktorëve të programeve, moderatorëve dhe pjesës së *brendit* grafik. Këta duhen stimuluar që të krijojnë asete televizive cilësore dhe bashkëkohore. RTSH-ja sot duhet të kufizojë konceptin e saj programatik dhe produksional, RTSH-ja duhet të guxojë të lidhë kontrata ose marrëveshje me kompani të mëdha produksionale si “Endemol” e të tjerë për formate televizive të suksesshme apo kompani të mëdha filmike për premiera filmi ose evente të rëndësishme.

Me ngritjen e uebit të ri, menaxhimi i përgjithshëm duhet të investojë në të ardhmen televizive, në median online, IPTV. Ky faktor duhet mbështetur shumë në teknologji, burime njerëzore e të tjera, pasi kjo është media e së sotmes dhe e së nesërme.

E fundit nga radha, por jo nga rëndësia, gjë që u ngrit edhe nga parafolësit, është investimi imediat që duhet të bëjë RTSH-ja për digjitalizimin e arkivës së saj, e cila përbën një thesar kombëtar televiziv, gjë që do ta kthente RTSH-në në majën e televizioneve shqiptare, aty ku edhe i takon. Në rast se nuk do të ndërhyhet shpejt, krejt kjo arkivë do të pësojë dëmtime të pariparueshme, ndërkohë që digjitalizimi i saj do ta bënte atë shumë të përdorshme, duke i shtuar së tepërmi edhe mundësinë e komercializimit të saj, e nënvizoj këtë, përfitime që do t'i shkonin vetë Televizionit publik shqiptar. Një gjë e tillë do të kontribuonte së tepërmi në ruajtjen e kujtesës kombëtare për brezat e rinj, që e njohin fare pak ose keq të kaluarën e vendit të tyre.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Hajdëri!

Kush ka pyetje?

Falënderoj zotin Hajdëri!

Vazhdojmë me kandidatin e radhës, zotin Arjan Sukniqi. Fjala për ju.

Nuk dëgjohet.

Vazhdojmë me kandidatin e radhës, zotin Shkreli.

Përshëndetje!

**Lumtor Shkreli** – Përshëndetje!

Ju falënderoj për mundësinë e dhënë për të qenë pjesë e kësaj dëgjese për pozicionin vakant të anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së! Unë quhem Lumtor Shkreli. Kam kryer studimet në Itali, ku kam përfunduar arsimin e mesëm për elektronikë dhe komunikacion dhe kam vazhduar më pas arsimin e lartë në Universitetin e Parmës, ku kam mbaruar degën ekonomi - biznes në vitin 2005. Jam specializuar po në këtë universitet në fushën ekonomike

dhe më pas kam kryer master pasuniversitar me objekt menaxhim objektesh pranë George Washington University në Washington DC. Kam kryer një seri specializimesh në Bruksel, Angli dhe Vjenë në fushat e planifikimit strategjik, prokurimit, ekonomisë, financës, menaxhimit dhe marketingut, si dhe marrëdhënie ndërkombëtare publike. Në Shqipëri jam kualifikuar në provimet shtetërore publike në fushat e mjedisit dhe të drejtës intelektuale, ku jam kualifikuar me titujt “Eksperti i licencuar i mjedisit”, nga Ministria e Mjedisit dhe “Ekspert i së drejtës intelektuale”, i certifikuar nga Drejtoria e Patentave dhe Markave pranë Ministrisë së Ekonomisë.

Aktualisht, kam një eksperiencë të gjatë profesionale në pozicionet administruese dhe drejtuese në institucionet publike dhe private në Shqipëri. Në institucionet publike kam qenë drejtues i nivelit të lartë pranë Agjencisë Nacionale të Transportit të Trafikut Ajror për një periudhë gati 5-vjeçare dhe më pas drejtues i Drejtorisë së Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave pas vitit 2013, për një periudhë 2- vjeçare. Aktualisht, jam pedagog i brendshëm pranë Universitetit Publik të Sporteve në Tiranë, ku jam lektor në fushat e ekonomisë, sportit dhe turizmit. Në sektorin privat jam pjesë aktive e disa kompanive private si konsulent dhe administrues.

Në eksperiencën time profesionale dhe arsimore, kam marrë pjesë në disa konferenca shkencore me tema sociale dhe publike, si dhe jam anëtar i disa shoqatave me karakter social, siç është dhe shoqata “Fëmijët sot” pjesë organizatës ndërkombëtare Plan Internantional, që më ka propozuar për këtë pozicion, e cila ka një larmishmëri aktiviteteve në Shqipëri, me donatorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, siç janë: ambasada amerikane, Kombet e Bashkuara, BE-ja e të tjera në fushën e të drejtave të njeriut, mbrojtje, edukimit me pjesëmarrjen e shtresave vunerabël të shoqërisë.

Duke qenë se roli i Televizionit shqiptar është ofrimi i një shërbimi publik, me karakter informimin, edukimin dhe argëtimin e publikut të gjerë, që përfshin të gjitha grupmoshat, kontributi im do të ishte vlerë e shtuar për këtë institucion të rëndësishëm të kombit tonë.

Duke qenë se Këshilli Drejtues i RTSH-së ka si kompetenca kryesore të veprimtarisë së tij çështje ekonomiko-financiare, siç janë miratimi i strategjisë së zhvillimit, analiza e raportit financiar, miratimi i planit financiar dhe buxhetit të vitit pasardhës, miratimi i projekteve me vlerë specifike të buxhetit vjetor, mendoj dhe besoj se eksperiencia ime profesionale, si dhe roli që kam pasur dhe kam në vendimmarrjet ekonomike do të ishte një kontribut i rëndësishëm personal për këtë institucion publik të rëndësishëm së veçantë kombëtare.

Së fundi, mendoj se roli im në pozicionin e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së do të jetë ai i përkushtimit, për të përfaqësuar më së miri interesat e shikuesve dhe dëgjuesve,

si dhe marrja e vendimeve me interes përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së në fushën e informimit, edukimit dhe argëtimit të publikut të vendit tonë.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit!

Kush ka pyetje?

Po, zoti Ylli.

**Fidel Ylli** – Më vjen mirë që sa herë bëhen debate ose diskutime kur ka vende vakante, janë gjithmonë artistë ose njerëz që punojnë në RTSH, por unë mendoj se bordi drejtues i RTSH-së ka nevojë edhe për ekonomistë, edhe për menaxherë, sepse duhet që, përveç parave që merr nga buxheti i shtetit, RTSH-ja të ketë edhe një vizion tjetër, për të gjetur burime financimi që të ketë mundësi t'i krahasojë dhe balancojë edhe rrogat e gazetarëve dhe punonjësve, që të jetë konkurrues në treg. Më vjen mirë që dëgjoj një ekonomist që shpalos vizionin tij, i cili ka dëshirë për të qenë pjesë e Bordit Drejtues të RTSH-së.

**Ramazan Gjuzi** - Faleminderit!

A ka pyetje? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Shkreli.

Fjala për kandidatin tjetër Arjan Sukniqi.

Nuk dëgjohet.

Vazhdojmë me kandidaten tjetër Rafaela Rica.

Nuk dëgjohet.

**Rafaela Rica**- Përshëndetje!

Kënaqësi që jam sot prezent këtu para jush për të paraqitur kandidaturën time për Këshillin Drejtues të RTSH-së.

Kam mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës, më pas kam mbaruar një master për administrim biznesi në Zvicër dhe prej vitit 2018 ndjek studimet për doktoraturë për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Menaxhim Ekonomik në Austri.

Prej vitit 1999 jam sipërmarrëse, kam themeluar dhe menaxhoj një nga agjencitë e para të marrëdhënieve me publikun dhe të komunikimit në Shqipëri, e cila quhet *Iceberg Communication*. Në vitin 2017 kam themeluar qendrën *Albanian Center of Audiovisual and Cinematography*, e cila merret me produksione, televizione, por jo vetëm; jam producente e një prej evidentëve më të mëdha të organizuara në industrinë vizuale në Shqipëri Balcan Film Market, ku në një farë mënyre kemi sjellë një Berlinale për Ballkanin në Shqipëri; si dhe jam bashkëthemeluese e shoqatës AWA, *Albania Women in Audiovisual* (Gratë shqiptare në audiovizual) që është edhe shoqata që më ka propozuar për këtë post.

Pse marr pjesë në këtë vakancë? Kjo lidhet me faktin që prej 21 vjetësh kam një eksperiencë goxha të gjerë në industrinë e marrëdhënieve me publikun, mediave dhe industrisë audiovizive. Gjithashtu, ajo që kam vënë re është edhe fakti që gjatë dekadave të fundit industria e mediave vizuale është përballur me një sfidë jashtëzakonisht të madhe si rezultat i revolucionit teknologjik, digjitalizimit dhe demokratizmin e përmbajtjes dhe shpërndarjen e tij, duke arritur deri tek industria e realitet virtual, ku të gjitha këto kanë pasur një ndikim shumë të madh në industrinë e medieve vizive.

Ajo që dua t'ju them është fakti se Televizioni shqiptar ka bërë një përmirësim shumë serioz në krijimin e përmbajtjes së programacionit dhe në cilësinë e transmetimit, i cili është *High Definition*, si dhe një përmirësim shumë të madh në fushën e teknologjisë dhe të digjitalizimit, duke kaluar tërësisht *online*, duke pasur tashmë një aplikacion dhe një përmirësim shumë të ndjeshëm të imazhit. Megjithatë, duke qenë një eksperte e komunikimit, e imazhit dhe marketingut mendoj se ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim.

Ajo që unë do të vija si objektiv kryesor për atë çka unë shoh si nevojë për përmirësim, është se Radiotelevizioni Shqiptar, duke qenë një nga mjetet dhe platformat më të mëdha të komunikimit, si dhe duke pasur një *background* si sipërmarrëse, do të luaja një rol kyç në zhvillimin e sipërmarrjes, duke krijuar më shumë emisione që promovojnë sipërmarrjen, emisione që promovojnë SME-të dhe të gjithë ekosistemin e *start up*-eve.

Si mund të bëhet kjo?

Kjo mund të bëhet nëpërmjet thellimit të traditës që ka pasur Radiotelevizioni Shqiptar në promovimin e rasteve të suksesit, identifikimin e talenteve të reja, kryesisht *start up*-eve, bizneseve të grave dhe vajzave dhe të promovimit të ideve novatore nga kushdo që mund të ketë një të tillë, krijimin e misioneve që kanë lidhje me biznesin me aktorët vendimmarrës, si dhe në përfshirjen e universiteteve si një pjesë e rëndësishme, të cilët mund të sjellin një ndryshim në sektorin social-ekonomik.

Një pjesë tjetër e rëndësishme sa i takon pjesës të Radiotelevizionit Shqiptar, për të cilin ka ende shumë për t'u bërë, edhe pse është bërë një punë shumë e mirë, lidhet me pjesën e krijimit dhe të forcimit të raundit, si dhe në sektorin e skenografive dhe të përmirësimit të imazhit. Unë propozoj që media të mos jetë më një media statike, por të jetë një media ndërvepruese me audiencën.

Në Radiotelevizionin Shqiptar ka programe shumë të mira, por mendoj që ka shumë nevojë për një optimizim të përdorimit të rrjeteve sociale dhe për një promovim më të mirë të këtyre emisioneve. Pra, duke jetuar në një kohë digjitale mendoj se ka shumë hapësira për përmirësimin e marketingut digjital, përmirësimin dhe optimizmin e motorëve të kërkimit.

Një aspekt tjetër ku mund të jepja kontributin tim lidhet me marketingun, duke qenë se menaxhoj një agjenci reklamash dhe komunikimi, sepse shoh që ka një buxhet shumë të ulët, i cili përthithet nga reklamat me gati 3-4% të buxhetit të Radiotelevizionit Shqiptar. Mendoj se ka një hapësirë shumë të madhe në thithjen e buxhetit marketing jo vetëm nga klientë të biznesit, ngaqë ka shumë hapësira që të mund të monitorohej ajo çka transmetohet në kanalet e Youtube dhe në platformat digjitale, nëpërmjet krijimit të mundësive dhe platformave *paper view*, siç është Netflix apo emisione të tjera, ndoshta jo në këtë moment, por në një moment tjetër.

Mendoj se kam një eksperiencë tepër të gjerë në këtë sektor. Duke qenë se merrem me promovimin e grave në biznes, si dhe jam bashkëthemeluese e AWA-s, synoj ndryshimin e kuotave dhe rritjen e përfaqësimit të grave në bordet dhe pozicionet drejtuese.

Po ashtu, duke qenë se prej vitesh kam bërë disa organizime ndërkombëtare në Shqipëri, por kam qenë edhe pjesëmarrëse e organizimeve të tjera ndërkombëtare jashtë vendit, kam krijuar një *network* shumë të mirë jo vetëm me profesionistë, por edhe me institucione dhe ente ndërkombëtare audiovizive.

Pra, duke krijuar një qasje shumë të mirë ndaj teknologjive të reja të komunikimit mendoj se edhe Radiotelevizioni Shqiptar duhet të jetë patjetër pjesë e këtyre evenimenteve dhe të ketë një bashkëpunim më të ngushtë në aktivitete të tilla që organizohen nga ne si producentë, por jo vetëm, apo edhe për evenimente të tilla që organizohen në Europë si Festivali i Filmit në Kanë, Berninale, Festivali i Venecias e shumë aktivitete të tjera.

Ju falënderoj!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Rica!

Fjalën e ka zonja Kumbaro.

**Mirela Kumbaro** – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Rica për prezantimin tuaj!

Kisha një pyetje për ju. A keni pasur eksperiencë bashkëpunimi...

**Ramazan Gjuzi** – Rregullojeni mikrofonin, zonja Kumbaro.

**Mirela Kumbaro** – Doja të dija, a keni pasur më parë ose gjatë përvojës suaj pranë agjencisë që drejtoni eksperiencë bashkëpunimi me Radiotelevizionin?

**Rafaela Rica** – Kam pasur disa eksperiencë bashkëpunimi. Në rastin konkret e kam pasur Radiotelevizionin Shqiptar si klient për disa bashkëpunime që unë kam bërë që nga viti 2000 për disa organizime, si “Talentit shqiptar në fund të shekullit”, i cili ka qenë një nga aktivitetet më të mëdha sa i takon vitit 2000 në mos gaboj, si dhe disa aktivitete të tjera po në mbështetje të fëmijëve jetim.

Më pas kam pasur disa bashkëpunime edhe në sektorin e marketingut, ku prej shumë vitesh kam dërguar disa nga klientët e mi që kanë futur fushatat e reklamimit në Radiotelevizionin Shqiptar. Kur më është kërkuar, kam bërë skenografi, duke qenë se agjencia që unë drejtoj merret edhe me ndërtim imazhi dhe skenografi kryeqytetesh e të tjera.

Pra, më duhet t'ju them se kam pasur një bashkëpunim të ngushtë dhe se e njoh mirë përveçse si shikuese, por edhe si bashkëpunëtoresh Radiotelevizionin Shqiptar.

**Mirela Kumbaro** – A nuk mendoni se mund të keni ndonjë konflikt interesi?

**Rafaela Rica** – Mendoj se jo, sepse nuk besoj që përfaqësoj një organizatë në konkurrencë me Radiotelevizionin Shqiptar, përkundrazi mendoj se do të ishte një vlerë e shtuar prezenca ime aty, për vetë faktin se nuk bëj konkurrencë me asnjë nga prodhimet që ne bëjmë. Pa diskutim, nëse do ta marr një funksion të tillë, besoj se nuk do të krijoja trafik influencash për t'ju marrë punën, sepse këtë e bëj aktualisht. Ajo që do të doja aktualisht është që të kisha zë në një media për të gjitha ato që bëj, qoftë në krijimin e imazhit, apo qoftë në suportimin e të rinjve dhe të grave në sipërmarrje. Mendoj se kjo gjë do të më ndihmonte për të dhënë kontributin tim në shoqëri dhe për ta çuar zërin më tej.

**Mirela Kumbaro** – Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Rica!

Po kaloj te kandidatja tjetër, zonja Suela Mino.

Përshëndetje, zonja Mino.

**Suela Mino** – Përshëndetje!

**Ramazan Gjuzi** – Fjala për ju.

Ju lutem, sa më shkurt!

**Suela Mino** – Së pari, ju falënderoj për mundësinë dhe kohën tuaj!

Së dyti, është një kënaqësi e veçantë për mua të jem këtu!

E gjithë përpjekja ime për të qenë pjesë e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar besoj se nis vite më herët, kur unë e kam filluar punën dhe karrierën pikërisht në këtë televizion, duke bërë *intershipin* si studente e gazetarisë.

Besoj se gjatë një rrugëtimi të gjatë me eksperiencë të ndryshme pune, vjen një çast i caktuar ku e gjithë përvoja mund të jetë një vlerë e shtuar dhe të hesht atë zërin që të mundon gjithmonë, sapo kontribuojmë përtej aktivitetit të përditshëm në një të mirë më të madhe që prek të gjithë shoqërinë.

Pra, duke qenë një person që e ka ushtruar profesionin e gazetarit, ku për një kohë të gjatë jam marrë me marrëdhëniet publike, ndërsa tanimë merrem posaçërisht me të shkruarin...

**Ramazan Gjuzi** – Mund të vazhdoni.

**Suela Mino** – Aktualisht punoj si kryeredaktore në shtëpinë botuese *UET Press* dhe në të gjithë këtë rrugëtim mbi 20-vjeçar përvojash pune, besoj se ka ardhur çasti reflektiv për secilin prej nesh, përtej punëve të vogla dhe përpjekjeve të gjithsecilit, për të kontribuar dhe për t'u ndier të vlefshëm si anëtarë të shoqërisë, duke kërkuar një medium që ta përfshijë të gjithë këtë kontribut.

Nga sa kam jetuar dhe punuar shpeshherë përpjekjet e vogla nuk mbërrijnë aty ku duam dhe nuk na ndihmojnë për të qenë zëplotë në komunitetin ku jemi, kështu që mendova ta hedh hapin për këtë kandidaturë, për të mos i lejuar vetes dhe që të jem thjesht qytetare e këtij vendi, e cila vuan pakënaqësitë dhe një standard etik që na prek të gjithëve, por sidomos të rinjtë dhe të vegjlit. E gjithë kjo besoj se merr kuptim në një medium si Radiotelevizioni Shqiptar, kontributi i të cilit është shumë i rëndësishëm në shoqërinë ku ne jetojmë, e cila në parimin dhe principet e saj ka tregun e lirë dhe konkurrencën, e cila në fushën e medias ka kosto të lartë, pasi shpeshherë medieve u duhet të mbijetojnë duke shkuar dhe përshtatur publikut.

Radiotelevizioni Shqiptar është i vetmi institucion që ka luksin, përgjegjësinë e madhe dhe detyrimin shoqëror për ta prirë publikun drejt një standardi etik dhe vlerash, të cilin kemi nevojë ta ushqejmë në shoqërinë e sotme shqiptare. Kjo është arsyeja bazë pse unë ndodhem këtu sot, duke besuar që me një sy të kujdesshëm, me një sens të përfurcuar dhe të ndjeshëm ndaj etikës në komunikim, shpalljes apo orientimit të publikut drejt një standardi vlerash të caktuara e gjithë kjo të mund të kthehet në një vlerë të shtuar dhe në një kontribut të përbashkët.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Mino!

I ftoj kolegët të bëjnë pyetje?

Po, zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Përshëndetje!

Kam një pyetje për zonjën Mino. Nga shërbimi i monitorimit të Kuvendit është shënuar që zonja nuk e ka dorëzuar librezën e punës dhe as ndonjë vërtetim tjetër, që provon se përmbush kriterin ligjor të përvojës së punës, se është një kriter përjashtues. Kur nuk i ka dërguar këto, si do ta vazhdojë garën? Kjo është pyetja.

**Suela Mino** – Në fakt, dosja e aplikimit është dorëzuar shumë më herët dhe, me sa di unë, janë përmbushur të gjitha kërkesat që ishin të reflektuara në lajmërim dhe në thirrjen, për shpalljen e kandidaturave. Ka shumë muaj që është dorëzuar dhe do të më duhet ta plotësoj, nëse ka hapësirë, përndryshe me vjen keq. Pa dyshim që librezat ime është e rregullt në çdo çast, edhe brenda ditës.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Mino!

Mund ta dorëzoni që sot librezën, sepse është një nga pikat që duhet të jetë.



Ka njeri tjetër pyetje?

Atëherë ftojmë kandidatin e radhës.

Fjala për zotin Petrit Ruka.

Përshëndetje, zoti Ruka!

Hapeni mikrofonin, ju lutem, se nuk dëgjoheni!

**Petrit Ruka** – A dëgjohem tani?

**Ramazan Gjuzi** – Po, përshëndetje!

**Petrit Ruka** – Përshëndetje dhe faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Shkurtimisht na thoni CV-në tuaj.

**Petrit Ruka** – Atëherë që të mos humbas kohë, unë jam prej 40 vitesh një kineast dhe kam punuar në kinostudion “Shqipëria e re” dhe më vonë në atë që u quajt “Albafilm studio”. Jam autor i mbi 45 skenarëve të të gjitha gjinive artistike, dokumentarë, filma multiaplikativë, ose vizatimorë, të cilët janë të ekranizuar dhe transmetohen prej shumë vitesh në kanale të ndryshme televizive, kam qenë 5 vjet kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, kam realizuar mbi 20 dokumentarë të ndryshme në televizionet shqiptare, kryesisht në Televizionin Publik Shqiptar, kam një marrëdhënie të gjatë me televizionet, kam punuar në disa televizione edhe si autor realizues i disa emisioneve, siç ka qenë “Jeta tjetër” te televizioni “Koha” në vitet 2005-2007. Kam qenë në një marrëdhënie shumë të ngushtë me ekranin, po kështu kam qenë për një periudhë 2-3 vjeçare anëtar i Këshillit Kombëtar të TVSH-së. Marrëdhënia ime si shkrimtar, por kryesisht si kineast me ekranin është e gjatë, eksperiencia ime është e madhe dhe them me modesti që jam një njohës i mirë i botës televizive, i medieve kryesisht. Po kështu kam kontribuar në medien e shkruar, jam titulluar me emërtimin “Mjeshtër i madh”, jam autor i disa çmimeve të para në rang Republike për letërsinë, i përkthyer në disa shtete me poezinë time, si në frëngjisht, rumanisht, greqisht, italisht dhe në disa gjuhë të tjera me pak të rëndësishme. Ndihem mirë që jam i ftuar të jap eksperiencën time si anëtar bordi, nëse do të konfiguroja fitues. Ndihem i shqetësuar për disa probleme që, me të gjithë punën e mirë të bërë, në disa televizione dhe kryesisht në ato kombëtare, që shpeshherë japin emisione, të cilat kanë, si të thuash, një lloj degradimi nga pikëpamja e mesazheve, nga pikëpamja e gjuhës, sidomos për gjuhën jam mjaft i shqetësuar dhe mjafton edhe një shikues fare i rëndomtë të vërë re qoftë dhe botën e titrimit në televizionin shqiptar, që shumë herë është gati skandaloz. Them se duhen gjetur forma stimuluese për të përmirësuar punën e këtyre emisioneve televizive, të cilat lënë shumë për të dëshiruar, pasi shpesh herë ato përfundojnë në një tavolinë dhe dy karrige; mungon dhe prodhimi, flas sidomos për televizionet kombëtare. Shpeshherë edhe bota e lajmeve vjen e vakët në trekëndëshin Tiranë-Durrës-Elbasan, a thua se Shqipëria mbaron në

trekëndëshin Tiranë-Durrës-Elbasan, dhe vetëm bota e krimit i detyron gazetarët tanë të lidhen me rrethe të skajshme me probleme, megjithëse duhet thënë që ka tendenca për disa emisione që janë vërtet shumë të mira, të cilat duhet të stimulohen për t'u bërë shembull për forcimin, aq më shumë pas kësaj pandemie, e cila nxori në plan të parë që bota e medieeve do të jetë sot një botë ekzistenenciale qoftë nga pikëpamja shtetërore, legjislativë, për komunikimin me qytetarët, por gjithmonë e më shumë po zbulohet që bota e medieeve do të jetë gjithmonë e më e pranishme në jetë, në funksionet shtetërore, në funksionet e tërë jetës sonë demokratike, të shkollimit, të arsimit, të edukimit e kështu me radhë. Nuk e di nëse koha ime premtonte për më shumë, por unë këto kisha.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Ruka!

**Petrit Ruka** – Faleminderit juve!

**Ramazan Gjuzi** – Fjala për zonjën Kumbaro.

**Mirela Kumbaro** – Faleminderit!

Në fakt, unë dua të vlerësoj modestinë ekstreme të zotit Ruka, që tha shumë pak nga ato që ka realizuar në jetë dhe në atë që quhet thesari i kulturës shqiptare dhe mendoj se nëse do të përfundonte ashtu si thatë ju, pra që të ishit fitues, do të ishte një vlerë e shtuar për Radiotelevizionin. Dua të përforcoj që më erdhi shumë mirë që ishit ndër të vetmit që ngritët disa probleme, të cilat kanë të bëjnë me disa gjëra që duken formale, por në fakt, janë thelbësisht formuese, siç është çështja e gjuhës, shtrirja e konceptit dhe e disa programeve. Sidomos televizionet kombëtare, që shkojnë gjithmonë e më shumë drejt komercializmit. Besoj se në këtë kontekst, në këtë situatë, është detyra e Radiotelevizionit Shqiptar që të na mbajë me këmbë në tokë për ato që janë vlera themelore. Ju i thatë shumë saktë zoti Ruka dhe nuk dua të shtoj, vetëm dua të reduktoja dozën e modestisë së tepruar që keni.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Kumbaro!

**Petrit Ruka** – Faleminderit juve, zonja Kumbaro!

**Ramazan Gjuzi** - Zoti Nasufi, fjala për ju.

**Fadil Nasufi** – Faleminderit!

Duke marrë shkas nga gjithë prezantimi i kandidateve pa bërë një lloj vlerësimi të diferencuar, vura re dy gjëra: ata që parashtruan vizion, që folën me zemër nga gjithë pasuria e dijes që kanë në botën e medias për problematikat që ka sot televizioni, ka edhe prurje që folën nga pikëpamja administrative dhe teknike. Unë dua të them që vëmendja jonë si komision, duhet të kthehet drejt profesionistëve dhe drejt krijuesve, që janë buka e dijes, janë buka shpirtërore, janë buka e kulturës dhe sot pata përshtypje të veçanta nga dy prurje krijuesish: nga i nderuari Petrit Ruka dhe Mevlan Shanaj, të cilët janë pasqyra e suksesit dhe

modelit, ku ne duhet të shohim të gjithë këta burra të mençur, që parashetrojnë probleme të qasjes së Televizionit Publik Shqiptar drejt publikut dhe drejt reformave, që duhet të bëjë ky televizion, pavarësisht se ne kemi filtrat e duhur dhe ato kuotat e përfaqësimit politik. Megjithatë, me kaq sa prezantuan, ata meritojnë vlerësimin e 12 kandidatëve për të thënë që do të jenë këta, pastaj të fillojë gara, që ne me gjithë mend t'i kthejmë këta njerëz me kaq vlera që ka Shqipëria.

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Nasufi!

**Petrit Ruka** – Ju falënderoj edhe nga ana ime, zoti Fadil!

**Ramazan Gjuzi** – Ju falënderojmë, zoti Ruka!

**Petrit Ruka** – Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Kalojmë në kandidatin e radhës, zotin Sukniqi.

Përshëndetje, zoti Sukniqi!

Hapeni mikrofonin!

Nuk dëgjohesh.

**Arian Sukniqi** – Unë ju dëgjoj shumë mirë.

**Ramazan Gjuzi** – Tani dëgjohesh.

Tani nuk dëgjoheni prapë. Nuk jeni lidhur.

Zoti Sukniqi, nuk dëgjoheni, hapeni mikrofonin, ju lutem!

**Arian Sukniqi** – E hapa.

**Ramazan Gjuzi** – Tani jeni në rregull.

**Arian Sukniqi** – Unë me kamera jam në rregull.

Jam në vështirësi se po flas nga makina, se sapo shtrova gruan urgjent në spital.

**Ramazan Gjuzi** – E morëm vesh dhe të shkuara!

**Arian Sukniqi** – Tani ideja është që unë jam ai që jam, kam një kontribut sidomos me Televizionin shqiptar, kam rreth 2200 orë xhirime të artit tim, duke futur 12 balete, numra të ndryshëm, festivale, me çmime ndërkombëtare. Çfarë janë në CV-i janë të verifikueshme realisht. Unë do të doja të jepja kontributin tim në KDRTSH, sepse e ndiej që nga përvoja që kam marrë, mund të kontribuoj, sepse, në fund të fundit, Televizioni shqiptar është një televizion publik, i cili mbështetet mbi dy shtylla, që janë informimi publik dhe edukimi. Në fushën e edukimit unë mund të jepja një kontribut shumë të madh, pasi, në fund të fundit, ai është një televizion publik, nuk mund të rrëshqasë në një televizion komercial, se ka detyrime shumë të mëdha karshi publikut dhe pjesa e parë është gjithmonë edukimi për një vazhdimësi të shëndoshë të shoqërisë.

Në Shqipëri këto vitet e fundit ka filluar edukimi midis artit dhe mund të ndihmoja shumë rubrika në këtë këshill me sugjerime që mund të ndërtoheshin rubrika të tëra gjithmonë në favor të edukimit, por pse jo, edhe të pjesës estetike e paraqitjes, sepse në fund fare ato shkojnë paralel.

E gjithë kjo është nga përvoja që kam.

Unë jam pjesëmarrës në shumë spektakle si regjisor, si koreograf, RTSH-në e njoh shumë mirë, jam rritur atje dhe e mendoj veten seriozisht që mund të kontribuoj diçka në televizionin publik shqiptar.

Nuk e di nëse keni ndonjë pyetje tjetër, por kjo është pak a shumë e gjithë gjëja. CV-në e keni. Nuk e di nëse keni diçka tjetër që mund të pyesni.

**Ramazan Gjuzi** – Jo faleminderit, zoti Sukniqi!

Ftojme anëtarët e komisionit të bëjnë pyetje.

Nuk ka pyetje.

Atëherë ju faleminderit, zoti Sukniqi!

**Arian Sukniqi** – Faleminderit edhe juve!

**Ramazan Gjuzi** – Dhe të shkuara!

**Arian Sukniqi** – Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Të nderuar anëtarë të komisionit, dëgjuam 11 kandidatë, na ka mbetur Ervin Nuriu, i cili për arsye objektive thotë se do të paraqitet në orën 12:45. Mund ta dëgjojmë edhe atë para se të fillojmë me ministren e Arsimit.

Po, zonja Kumbaro.

**Mirela Kumbaro** – Unë propozoj, zoti kryetar, që, nëse dy kolegët janë dakord...

**Ramazan Gjuzi** – Nuk dëgjoheni mirë. Afrojeni mikrofonin!

**Mirela Kumbaro** – Më dëgjoni tani?

Unë propozoj që pasi dëgjuam 11 kandidatët, pra ishin 11 dëgjesa, dhe secili nga ne ka nevojë të reflektojë, të bëjmë një ndërprerje, të rilidhemi prapë në 12:45 që të dëgjojmë kandidatin e fundit, pastaj të bëjmë dëgjuesën me ministren e Arsimit. Unë mendoj se nuk është sot koha për të votuar, por të reflektojë secili prej nesh dhe të bëjmë një seancë të dedikuar në analizimin e kandidatëve. Siç kemi bërë herë tjetër, do të sugjeroja që analiza e kandidatëve dhe e dëgjësave të bëhet me dyer të mbyllura, në respekt të profilit të secilit prej kandidatëve dhe për të mos krijuar asnjë lloj autocensure te kolegët.

**Ramazan Gjuzi** – Kush është dakord që të caktojmë një datë tjetër?

Kundër, abstenime nuk ka.

Miratohet.

Atëherë këtë seancë dëgjimore e deklaroj të mbyllur.

**Mirela Kumbaro** – Edhe një gjë tjetër kryetar, por që mund ta diskutojmë edhe pastaj: ju thatë që duhet të caktojmë një datë, mendoj se mund të lëmë ditën e premte, data 5, por do të na duhet një orë kohë për të marrë vendimin mes nesh.

Si mendoni kolegë?

**Fadil Nasufi** – Jo, se kam angazhime.

**Mirela Kumbaro** – E di, por meqë jemi *online* Fadil.

**Ramazan Gjuzi** – E lëmë të hënën atëherë.

**Mirela Kumbaro** – Më duket se të hënën kemi seancë parlamentare.

**Ramazan Gjuzi** – Nuk kemi njoftim.

**Mirela Kumbaro** – Mirë atëherë e bëjmë nesër?

*(Pas ndërprerjes, ora 12.45 minuta)*

**Ramazan Gjuzi** - Vazhdojmë me kandidatin e fundit, Elvin Nuriu. Përshëndetje, zoti Nuriu!

**Elvin Nuriu** – Përshëndetje të gjithëve, të nderuar!

**Ramazan Gjuzi** – Shkurtimisht, bëni prezantimin e CV-së suaj.

Fjala për ju.

**Elvin Nuriu** – Përshëndetje të gjithëve!

Ju falënderoj për kohën e gjetur në këtë orar!

Unë jam Elvin Nuriu, kam një eksperiencë prej 10 vjetësh në fushën e drejtësisë. Kam studiuar për drejtësi nga viti 2005 deri në vitin 2009. Në vitin 2010, kam kryer studimet master për të drejtën ndërkombëtare tregtare në Universitetin e Romës në Itali. Gjatë kësaj periudhe kam kryer shumë trajnime të cilat janë të shkruara aty, por unë shkurtimisht po përmend disa nga më të suksesshmet, siç ka qenë shkolla e studimeve politike e Këshillit të Europës në periudhën 2014-2015. Kam kryer disa trajnime të tjera gjatë kohës që kam qenë në funksione të ndryshme pune. Eksperienca e fundit ka qenë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, si drejtues i administrimit të përgjithshëm. Duke qenë se kam pasur këtë pozicion pune, di pak a shumë, zhvillimin e pozicionit të punës për të cilin unë po aplikoj.

Shkurtimisht, dëshira për të aplikuar si anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së, nuk vjen se jam pjesë e ndonjë partie politike, s'jam pjesë e asnjë partie politike, asnjë krahu, as në media dhe nuk kërkoj të bëhem pjesë e saj, sepse mendoj se jam njeri i lirë, për të vepruar dhe për të vendosur. Këtë dëshirë e konsideroj si detyrë me përgjegjësi, ekstra ndaj angazhimeve të përditshme, që ka një impakt të madh në shoqërinë ku jetojmë, si dhe veçanërisht për të ardhmen e vendit tim, duke qenë se Radiotelevizioni Shqiptar, është dhe ka qenë bërthama e

radiotelevizioneve publike, private, si dhe një zë i fuqishëm në shoqërinë shqiptare. Si profesionist në drejtësi dhe si avokat i shtresave të ndryshme, preferoj të qëndroj aty ku jam sot, në anën e publikut, pasi, vetëm nëse ndjekim nevojat e publikut mund të kemi sukses të plotë, RTSHA- ja vetë si entitet publik dhe rrjedhimisht nuk do të duhet të ketë problematika të pagesave të qytetare, të cilët i bëjnë ato periodikisht sipas udhëzimeve.

Në lidhje me kohën dhe situatën ku jetojmë për median dhe RTSH-në, në veçanti e shikoj shumë larg nevojës së publikut, sidomos institucionet e drejtësisë dhe të administratës publike. Pa mohuar punën e madhe të portalit të bashkëqeverisjes, të udhëhequr nga Kryeministri Edi Rama, e cila jo në pak herë si me magji ka zgjidhur situata politike shumëvjeçare, nuk e shoh të njëjtën përgjegjshmëri nga Radiotelevizioni Shqiptar në veçanti. Do të doja që Radiotelevizioni Shqiptar të ishte më i predispozuar të afronte institucionet tek qytetari, jo duke intervistuar drejtuesin e x institucioni, si në shumë raste, i cili lexon statistikat, por duke ftuar specialistin, ai që ka të bëjë direkt me qytetarin, duke bërë pjesë të një programi, duke futur kameran dhe duke shfaqur atë që një qytetar ia mundëson të shohë në jetën e përditshme të tij.

Për sa më sipër, dëshiroj që qytetarët të njihen me gjykatën, të njihen me prokurorinë, të njihen me doganën, të njihen me ALUIZNI-n, të njihen me hipotekën, me shumë institucione publike për të cilat hamendësohet se gëlon korrupsioni i madh. Ky konstatim nuk është vetëm për këtë qeveri, por për gjatë gjithë këtij 30-vjeçari janë të njëjtat problematika që kanë qenë, po që në mendimin tim nuk janë të vërteta dhe nuk kanë bazë juridike.

Unë e vlerësoj punën e mirë për sa i përket transmetimeve digjitale që ka ndërmarrë Radio Televizioni Shqiptar dhe këshillat e mëparshëm drejtues dhe gamën e pasur të transmetime, por puna e këshillit drejtues nuk duhet të mjaftohet vetëm në kaq, ajo duhet të jetë më largpamëse për të përballuar zhvillimet e teknologjisë informatike e cila ditë për ditë po zhvillohet. Vazhdimisht u kërkohen të dhëna të pavarura mbi produktin që RTSH nxjerr në treg, pasi vetëm nëse ka transparencë mund të rrisë cilësinë e programacionit dhe të transmetimit. Unë si kandidat i ardhshëm, nuk premtoj çudira, nuk premtoj asgjë nga sa kam në dorë të bëj, por do të jem një avokat në mbështetje të interesit publik, atij publiku që mezi ia del të mbyllë muajin pa marrë borxh, atij të papunit që trajtohet me ndihmë ekonomike apo të atij pensionistit fshatar që ka të ardhura minimale dhe ndoshta nuk di as të shkruajë apo të lexojë.

Unë kaq kam, për sa i përket prezantimit, të nderuar deputetë.

**Ramazan Gjuzi** – Ju faleminderit, zoti Nuriu!

Kush ka pyetje nga anëtarët e komisionit?

Po, zonja Kumbaro.

**Mirela Kumbaro** – Ajo që më nxiti më shumë zoti Nuriu, kuptova që në përvojën tuaj dhe duke lexuar CV-në tuaj, përgjithësisht jeni larg botë së medias dhe radios dhe televizionit. Sa mendoni që kjo mosnjohje e këtij institucioni dhe këtij pushteti të katërt, do të jetë pengesë për ju, për të kontribuar apo mendoni, përkundrazi do të jetë një argument për të kontribuar në përbërjen e Këshillit Drejtues të radiotelevizionit? Sepse kuptova që në eksperiencën tuaj nuk keni pasur ndonjëherë të bëni dhe keni një perceptim të përgjithshëm si i gjithë publiku. Cili është interesi juaj për të qenë pjesë e këtij këshilli, duke mos pasur lidhje në jetë dhe në profesionin tuaj me të?

**Ramazan Gjuzi** – E dëgjuat mirë?

**Elvin Nuriu** – Po.

Ju falënderoj për pyetjen

Konstatimi është i drejtë. I qëndroj tezës së dytë, duke mos qenë pjesë e medias. Për mendimin tim anëtarët këshillit jo domosdoshmërisht duhet të kenë pasur lidhje me median. Pse? Sepse mendoj që ka një kriter, i cili mendoj se duhej të vendosej si kriter ligjor, konflikti i interesit. Domethënë, në qoftë se ne shohim ish-drejtues, të cilëve u ka mbaruar mandati apo u ka mbaruar ekzistenca e atij funksioni dhe ne e marrim dhe e fusim përsëri këtu, domethënë bëhet një rreth vicioz, ku njerëzit e medias nuk dinë se çfarë bëhet poshtë. Domethënë, nuk dihet se çfarë bëhet te publiku i gjerë. Unë prandaj jam dhe i qëndroj tezës që, unë do të jem përherë në anën e publikut. Mendoj se integriteti im, ndershmëria ime dhe eksperiencia ime në situatat e ngjashme në lidhje me marrëdhënien me publikun, në lidhje administratën shtetërore, në lidhje me miradministrimin e buxheteve apo burimeve njerëzore, janë një gur themeli për të cilën unë nuk e kam fare problem apo frikë marrjen e kësaj detyre.

Unë i qëndroj tezës që, nëse publiku është i kënaqur, Radio Televizioni Shqiptar do të ketë përherë sukses. Nëse ne mbetemi te kupola lart, po vendosim në këshillin drejtues njerëz të medias, njerëz profesionistë të medias, pa i hequr asnjë pikëpyetje apo gjëra atë tjera, them se jemi shumë larg kërkesave të publikut. Domethënë, kjo e bën Këshillin Drejtues të RTSH-së të suksesshëm, diversifikimi i anëtarëve nga fusha të ndryshme të jetës.

**Ramazan Gjuzi** – Ju faleminderit, zoti Nuriu!

**Elvin Nuriu** – Ju falënderoj për kohën!

**Ramazan Gjuzi** – Mund të largoheni.

**Elvin Nuriu** – Faleminderit!

Ditën e mirë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**Tiranë më 03.02.2021, ora 13:00**

**Drejton mbledhjen:**

**Ramaza Gjuzi – Kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës**

2. Seancë dëgjimore me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështjet:

- Ecuria e procesit të eliminimit të pasojave të tërmetit të 26 nëntorit 2019, në rindërtimin dhe ndërtimin e objekteve mësimore në sistemin e arsimit parauniversitar, si dhe në sistemin e arsimit të lartë.
- Si po funksionon transporti i nxënësve dhe mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar.
- Çështja e përjashtimit të të diplomuarve me master shkencor nga konkurrimi për mësues në shkollat publike.

**Marrin pjesë:** Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello Imset Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelian Rista, Bujar Çela, Almira Xhambola, Lindita Nikolla Klajdi Qamo, Kostaq Papa, Sekam Jnenishi.

**Mungojnë:**

Fatjona Dhimitri, Erion Piciri, Enada Kapllani, Amra Barova.

**Të ftuar:**

- Evis Kushi – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
- Zamira Gjini - drejtore e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
- Selman Hodaj - drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

## HAPET MBLEDHJA

**Ramazan Gjuzi** – Mirëdita të nderuar kolegë!

Atëherë, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Siç jeni njoftuar, në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore me ministren e Arsimit Sportit dhe Rinisë, zonjën Evis Kushi, për çështjet si më poshtë: Ecuria e procesit të eliminimit të pasojave të tërmetit të 26 nëntorit 2019, rindërtimi dhe ndërtimi i objekteve mësimore në sistemin e arsimit parauniversitar, si dhe në sistemin e arsimit të lartë. Si po funksion transporti i nxënësve dhe i mësuesve në sistemin parauniversitar, si dhe një kërkesë që ka ardhur nga një shoqatë për përjashtimin e të diplomuarve me master shkencor nga konkurrimi për mësuese në shkollat publike, për të cilën ministra na ka përcjellë materialin me shkrim, për të trija çështjet.

Përpara se të fillojmë, verifikojmë kuorumin, Mirela Kumbaro prezent. Fidel Ylli prezent. Musa Ulqini prezent. Vilma Bello prezent. Imset Beqiraj prezent. Fadil Nasufi prezent. Adelian Rista prezent. Bujar Çela prezent. Almira Xhambola prezent. Lindita Nikolla prezent. Klajdi Qamo present, Kostaq Papa present, Selami Jenisherri prezent. Nukjanë prezent: Fatjona Dhimitri, Erion Piciri, Enada Kapllani, Amra Barova.

Atëherë, kuorumi i nevojshëm është. Ministrja e Arsimit është prezente.

Atëherë, kalojmë në seancën dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjë Evis Kushi.

Përshëndetje, zonja Kushi!

Mirë se keni ardhur!

**Evis Kushi** – Përshëndetje!

Faleminderit për ftesën!

**Ramazan Gjuzi** – Fjala për ju.

**Evis Kushi** - I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Së pari, ju falënderoj për këtë seancë dëgjimore dhe për mundësinë që të diskutojmë së bashku rreth disa çështjeve me rëndësi të veçantë në fushën e arsimit parauniversitar!

Unë prezantimin po e ndaj në 3 pjesë, bazuar në çështjet që ky komision i nderuar ka kërkuar të trajtojmë sot.

Së pari, në lidhje me ecurinë e procesit të eliminimit të pasojave të tërmetit të 26 nëntorit për objektet arsimore. Së dyti, në lidhje me transportin e nxënësve dhe, së treti, në lidhje me përjashtimin e të diplomuarve me master shkencor nga konkurrimi për mësues në shkollat publike.

Pra, këto janë tri çështjet, ku do të përqendrohet diskutimi im dhe më pas, natyrisht jam shumë e hapur, së bashku me kolegët e mi të ministrisë për t'u përgjigjur pyetjeve apo çështjeve të tjera që mund të ngrenë të gjithë anëtarët e komisionit.

Së pari, në lidhje me ecurinë e procesit të eliminimit të pasojave të tërmetit të 26 nëntorit për rindërtimin e objekteve arsimore në sistemin e arsimit parauniversitar, por edhe arsimit të lartë. Që në fillim dua të them se të gjithë e dimë se çfarë ndodhi më 26 nëntor, ku një tërmet i fuqishëm tronditi Shqipërinë dhe përveç pasojave të rënda në shtëpi, në jetë të humbura, për fat të keq, tërmeti dëmtoi gjithashtu dhe qindra institucione arsimore, në të cilat edhe sot që flasim po vijon puna me shumë intensitet për rindërtimin e tyre.

Rikonstruksioni dhe rindërtimi i institucioneve tona arsimore, po zhvillohet nën moton *building back beter*, që do të thotë “të rindërtosh më mirë” dhe kjo nënkupton që ndërtimet e reja janë më të mëdha, më të forta, më të sigurta, janë të standardeve ndërkombëtare eurokod 8, që garantojnë madje dhe eficiencë energjie për mbrojtjen e mjedisit. Për projektimin e shkollave të reja dhe përmirësimin e ndërtesave ekzistuese, janë marrë në konsideratë kërkesat e të gjithë përdoruesve, duke filluar nga nxënësit, mësuesit, stafi i administratës, prindërit, autoritetet lokale, pra, le të themi, i gjithë komunitet përfitues. Të gjitha shkollat do të kenë një infrastrukturë bashkëkohore, do të kenë laboratorë, ambiente sportive në natyrë dhe palestra të brendshme, biblioteka, do të kenë dhomat e mjekut dhe të punonjësve të shërbimit psiko-social, si dhe të gjitha lehtësitë për të gjithë fëmijët me aftësi ndryshe, duke plotësuar kështu të gjitha standardet, sipas vizionit tonë, për të qenë shkolla qendër komunitare. Në procesin e rindërtimit janë të përfshira 167 objekte të fushës së arsimit, ku këtu përfshihen çerdhe, kopshte, shkolla të arsimit parauniversitar, shkolla të mesme profesionale, konvikte të shkollave të mesme profesionale dhe godina universitare. Pra, në total kemi 167 objekte të fushës së arsimit. Nga këto 167, 108 objekte janë shkolla nëntëvjeçare dhe të mesme, ku numri i përfituesve është rreth 42 mijë nxënës. Donatorët e financimit të objekteve shkollore, pra përveç Ministrisë së Rindërtimit dhe buxhetit të shtetit që ka një fond të përcaktuar të dedikuar për këtë qëllim, kemi gjithashtu donacione nga Bashkimi Europian, nga banka KfV, nga Katari, nga Republika e Sllovakisë, nga Republika e Sllovenisë, si dhe Republika e Kroacisë.

Aktualisht, kanë përfunduar punimet në 25 objekte, pra sot që flasim 25 objekte arsimore kanë përfunduar, ndërkohë që 10 objekte të tjera përfundojnë punimet në fund të muajit shkurt dhe objektet e tjera janë në vijim e sipër. Dua të theksoj që, në të gjitha objektet që janë parashikuar të kryhen me buxhetin e shtetit, puna ka filluar. Kemi ende një pjesë të shkollave ose të objekteve arsimore që do të financohen nga Bashkimi Europian, që nuk kanë filluar ende, sepse janë në fazën e dytë dhe ata janë duke ndjekur procedurat e tyre, por të

gjitha objektet arsimore që do të financohen me buxhetin e shtetit, kanë filluar tashmë nga puna dhe parashikohet që në muajin qershor të përfundojnë të gjitha. Pra, në vitin shkollor të ardhshëm, të gjitha këto shkolla do të jenë gati për të pritur nxënësit. Këto janë, pak a shumë informacionet. Nëse doni numrin e saktë të këtyre objekteve arsimore, unë mund t'ju them që çerdhe janë 4, kopshte janë 29, shkolla nëntëvjeçar dhe të mesme 108, shkolla profesionale 4, konvikte për shkollat e mesme dhe profesionale janë 4, konvikte të arsimit të lartë janë 17 dhe qendra sociale 1. Pra, në total janë 167 objekte arsimore dhe e theksoj “objekte arsimore”, sepse nuk janë vetëm shkolla, por janë edhe çerdhe, kopshte, konvikte apo qendra të tjera. Nëse do të keni pyetje të tjera në lidhje me këtë çështje, unë jam e hapur, por ky është informacioni fillestar.

Po kaloj te çështja dytë që lidhet me transportin e nxënësve. Po përpiqem që të jem sa më koncize, që të mos marr shumë kohë dhe që të kemi mundësi të diskutojmë së bashku për çështje që lidhen me këto të treja. Në lidhje me funksionimin e transportit të nxënësve dhe, natyrisht, të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar, dua t'ju them që, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 682 të vitit 2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë, që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë siguron transport edhe për nxënësit, edhe për mësuesit, dhe dua ta theksoj, për nxënësit që kanë vendbanim mbi 2 kilometra nga shkolla dhe mësuesit për arsimin bazë dhe kopshtet publike, të cilët punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit apo fshatit, në largësinë 5 kilometra nga kufiri i njësisë përbërëse administrative të vendbanimit të tyre të përhershëm; është fjala këtu për ata mësues që shkojnë e kthehen brenda ditës.

Për vitin 2020 është bërë një rritje e numrit të nxënësve dhe mësuesve, e realizuar përsëri me vendim të Këshillit të Ministrave, për shkak të situatës pas tërmetit të vitit 2019 dhe këtu kanë përfituar nxënës që kanë vendbanimin mbi 2 kilometra nga shkolla dhe mësues që punojnë mbi 5 kilometra nga vendbanimi apo qendra e përhershme e punës në shkollë, si dhe për të gjithë nxënësit dhe mësuesit e shkollave të cilat mund të jenë dëmtuar nga fatkeqësi natyrore. Këtu nuk nënkuptojmë vetëm arsimin bazë dhe kopshtet, por kemi përfshirë, madje, edhe arsimin e mesëm dhe atë të lartë (pra të gjithë sistemin parauniversitar). Thënë shkurt, për të gjithë ata nxënës dhe mësues shkollat e të cilëve janë dëmtuar nga tërmeti, janë përfshirë në këtë VKM, në mënyrë që t'u rimbursohet transporti, sipas specifikimeve që përmenda pak më lart.

Për vitin 2020 u sigurua transporti për 35 800 nxënës që kanë vendbanim mbi 2 kilometra nga shkolla, 12 800 mësues që punojnë mbi 5 kilometra nga vendbanimi apo qendra

e përhershme e punës në shkollë, duke përfshirë të gjithë nxënësit e shkollave të dëmtuara nga tërmeti. Në total buxheti i akorduar për transportin ka qenë 750 milionë lekë. Natyrisht, me rindërtimin e shkollave të dëmtuara nga tërmeti, siç e thashë pak më lart, që ne presim që një pjesë e madhe e tyre të përfundojnë në muajin qershor, por edhe me rikonstruksionin, ndërtimin e shkollave nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve gjatë vitit 2021, ne do të kemi një përmirësim të situatës së transportit, sepse nxënësit dhe mësuesit nuk do të kenë më nevojë për transferim. Pavarësisht këtij përmirësimi të pritshëm, ne, gjithsesi, këtë vit kemi parashikuar në buxhet të njëjtin fond, pra 750 milionë lekë për transportin, për të qenë, gjithsesi, të përgatitur për çdo situatë.

Pagesa e transportit të mësuesve dhe nxënësve në zyrat vendore arsimore është menaxhuar në mënyra të ndryshme: në disa zyra arsimore janë bërë procedurat e prokurimit dhe janë përzgjedhur operatorët ekonomikë të cilët kryejnë transportin, ndërkohë që në disa zyra të tjera ka mungesë të operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye është bërë kalimi i pagesës në llogari bankare ose nëpërmjet Postës Shqiptare te familjet përfituese.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që sigurimi i transportit ka vështirësi dhe problematika të ndryshme, që lidhen me shumë faktorë, pavarësisht përpjekjeve tona të vazhdueshme në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe me pushtetin vendor. Tarifat janë të ulëta. Harta e linjave është shumë më komplekse dhe më e degëzuar sesa linjat që janë të licencuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ka mungesë të linjave dhe distancave nga fshati në fshat. Ka, gjithashtu, mosplotësim të specifikimeve teknike dhe parametrave të mjeteve të vendosura me një vendim, i cili mban datën 28.12.2015 për transportin e nxënësve, e cila nënkupton se jo çdo operator mund t'i plotësojë kushtet apo parametrat teknikë për të transportuar nxënësit, si dhe plot problematika të tjera, për të cilat, siç e thashë, ne jemi të ndërgjegjshëm që ekzistojnë dhe, natyrisht, i kemi në fokusin tonë, i kemi në prioritetin e punës sonë për t'i zgjidhur këto probleme.

Aktualisht janë paguar të gjithë muajt e periudhës nga janari në nëntor të vitit 2020 dhe tani po bëhen procedurat për pagesën e muajit dhjetor. Ndërkohë, për vitin 2021 janë në proces zhvillimi të gjitha procedurat e prokurimit deri në mbylljen e tyre për pagesat e transportit për nxënësit dhe mësuesit që kryhen me llogari bankare apo nëpërmjet Postës Shqiptare. Kaq edhe për sa i takon transportit të nxënësve dhe, siç e thashë më sipër, jam e hapur natyrisht që ta diskutojmë më tej dhe pres, madje, edhe sugjerimet tuaja, sepse ky është një problem shumë kompleks për të cilin ne kemi kohë, madje edhe vitet e kaluara ka qenë prioritet kryesor zgjidhja e këtij problemi, por që për shkak të faktorëve të ndryshëm, për shkak të arsyeve të ndryshme, ka ende vështirësi në zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi.

Së treti, ka ardhur një shqetësim që lidhet me përjashtimin e të diplomuarve me master shkencor nga konkurrimi për mësues në shkollat publike.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj që formimi profesional i mësuesve është parashikuar në nenin 57 të ligjit nr. 69 të vitit 2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, në nenin 83 të ligjit nr. 80 të vitit 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 4 të ligjit nr. 10 171 të datës 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Pra, ky është legjislacioni në fuqi për sa i takon formimit profesional të mësuesve. Bazuar në këtë legjislacion, aktualisht të diplomuarit që kanë ndjekur programe studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave në mësuesi” dhe janë pajisur me diplomën përkatëse në fushën e arsimit të kryer, nuk përjashtohen nga konkurrimi për dhënien e provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, por theksoj “Master i Shkencave në Mësuesi” nënkupton që në kurrikulën mësimore të kryer gjatë studimeve të tyre, kanë zhvilluar edhe lëndë të formimit psiko-pedagogjik në ciklin e dytë të studimeve. Nga ana tjetër, duhet të sqarojmë se programet e studimit “Master i Shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si dhe me aftësinë për kërkimin shkencor në një fushë të caktuar. Nëse këto programe nuk janë kryer në fushën e mësuesisë, gjatë të cilave të jenë kryer lëndë të formimit psiko-pedagogjik, këta të diplomuar përjashtohen nga konkurrimi për dhënien e provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, pra të licencës, sepse përmbajtja kurrikulare e zhvilluar gjatë programit të studimit të tyre nuk ka pasur në fokus formimin e tyre profesional si mësues, por pajisjen e të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësinë për kërkim shkencor.

Për ta bërë më të qartë, mund t’juja konkretizoj me një shembull. Pra, nëse një shtetas, një student, ka përfunduar studimet në ciklin “Master i Shkencave në Kimi”, duke u pajisur kështu me diplomën përkatëse me këtë emërtim, pra për fushën e arsimit të kryer në kimi, ai nuk mund të jetë kandidat për dhënien e provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, le të themi, nuk mund të marrë licencë, sepse studimet e kryera nga ana e tij nuk janë në fushën e mësuesisë dhe ai nuk ka zhvilluar lëndë të formimit psiko-pedagogjik, që janë të detyrueshme për formimin profesional të një mësuesi. Por, nëse një shtetas, pra student, ka përfunduar studimet dhe është pajisur me diplomën përkatëse “Master i shkencave në fushën e arsimimit” “Mësuesi për arsimin e mesëm - të lartë në kimi”, pra kemi dallimin që përfshin mësuesinë, ky shtetas me diplomën e fituar ka të drejtë të marrë pjesë në provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, në këtë rast në mësuesi, pas kryerjes me sukses të praktikës

profesionale, pasi në kurrikulën e zhvilluar gjatë ndjekjes së studimeve të larta ai e ka marrë formimin e duhur për mësuesi, siç rezulton edhe në emërtimin e diplomës përkatëse.

Si konkluzion, për ta bërë edhe një herë më të qartë dhe më të përmbledhur, në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, kandidati për të dhënë provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit, pra për të hyrë në provimin e licencës, duhet të plotësojë këto tri kushte.

Së pari, të ketë fituar diplomën e ciklit të parë *bachelor* në fushën e arsimit të mesëm-të ulët dhe të arsimit të mesëm-të lartë; së dyti, të ketë diplomën e ciklit të dytë master me 120 kredite në fushën e mësuesisë dhe, së treti, të ketë kryer me sukses praktikën...(nuk dëgjohet)

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Ministre!

Ftoj anëtarët e komisionit të drejtojnë pyetje.

Kush e do fjalën?

Po, zoti Beqiraj, fjala për ju.

Hapeni mikrofonin, zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Por e kërkoi fjalën zoti Musa në fillim.

**Ramazan Gjuzi** – Nuk e ngriti dorën.

**Ismet Beqiraj** – Po, po.

**Ramazan Gjuzi** – Vazhdoni, zoti Ulqini, fjala është për ju.

**Musa Ulqini** – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Ministre, ju falënderoj shumë për informacionin, i cili ishte një informacion, siç e kemi kuptuar ne, i qartë, i shkurtër dhe besoj shumë i dobishëm për ne.

Meqenëse zona ku unë jam deputet, Belshi, nuk është zonë që trajtohet për tërmetin dhe ne nuk kemi pasur probleme, unë dua të them pak fjalë për çështjen e dytë. Jam konsultuar dje me drejtues të bashkisë, të zyrës arsimore, me drejtues shkollash e kopshtesh, por edhe me qytetarët për çështjen në fjalë dhe dua të them që kam ngelur i befasuar nga takimi që kisha në fshatin Turbull, në njësinë administrative Kajan, se sa të qartë ishin të pranishmit për mënyrën se si qeveria “Rama” dhe ju e keni trajtuar këtë çështje. Sepse në Bashkinë e Belshit janë 204 mësues dhe 175 prej tyre përfitojnë nga transporti falas. Në këtë mënyrë ne kemi mundësi që atje të vijnë mësues nga më të mirët nga Elbasani. Pra, është një masë shumë e madhe që i ndihmon shumë mësuesit.

Nga 31 edukatorë që janë në zonën e Dumresë, 21 prej tyre përfitojnë nga transporti falas. Ndërkohë, Belshi ka 2002 nxënës dhe 776 përfitojnë transport falas, meqenëse distancën e kanë më shumë se 2 kilometra nga shtëpia dhe nga 419 fëmijë që ndjekin parashkollorin, 92 përfitojnë nga kjo e drejtë.

I përmenda këto shifra për të thënë, madje, sepse sapo dëgjova edhe përfaqësuesin e opozitës dhe duke e ballafaquar atë çfarë ju thatë, atë çfarë unë shikoj në territor, atë çfarë dëgjohet, qartësinë që dëgjova nga banorët e fshatit Turbull, pra, m'u duk shumë e paqartë ose e pasaktë ajo që unë dëgjova nga opozita, sepse ata kërkojnë të bëjnë gjëra që ne i kemi bërë, i kemi jetësuar, i prekim me dorë përditë dhe është një ndihmë e madhe, pavarësisht nga situata e vështirë buxhetore që ka qeveria. Unë ju nxis dhe ju përgëzoj për mënyrën se si vazhdoni ta trajtoni këtë çështje në krye të institucionit që ju drejtoni.

Shumë faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Ju faleminderit, zoti Ulqini.

Fjalën e ka zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Faleminderit!

Faleminderit për informacionin, kolege e nderuar, Kushi!

Ishte një informacion shterues për situatat e programit të rindërtimit në zonat e dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019 dhe sidomos për dëmet në sistemin arsimor.

Sigurisht, ne përditë, pikërisht edhe ne këtu në komision, duhet ta evidentojmë dhe është momenti i duhur që të ballafaqohemi me realitetin, edhe pse në kushtet e situatës pas tërmetit, edhe pse në kushtet e izolimit gati total nën presionin e madh të pandemisë, kantieret e ndërtimit vazhdojnë. Përditë promovohet e gjithë puna dhe programet e realizuara sigurisht në një situatë të tillë, kur gati-gati mbi 25% e objekteve të ndërtuara pothuajse janë finalizuar, sipas standardeve të Eurokodit 8, që njerëzit nuk e kuptojnë këtë standard, sikurse po bëhen edhe shtëpitë, të cilat nuk po bëhen më, të më falë Musai, si shtëpitë elbasançe, dhomë-kuzhinë-dhomë dhe një korridor në mes, por po bëhen me standardet e eurokodeve europiane, me të gjithë infrastrukturën, me të gjithë komfortin e një komuniteti në fshat, në qytet, në lagje dhe kudo.

Sigurisht, ne e pranojmë që kantieret janë hapur me fondet që mbështeten edhe nga qeveria, edhe me fondet e donatorëve, por donatorët kanë edhe procedura më burokratike në këtë drejtim. Dëme nga tërmeti nuk pati vetëm sistemi arsimor brenda kornizës gjeografike të shpallur në fatkeqësi natyrore, por ka pasur edhe në zona të tjera pranë tyre dhe më larg.

Sikurse e tha edhe Musai, shqetësime të tilla kanë edhe të tjerët, por unë do t'i bëja një pyetje direkte ministres për çështjen e parë: a është menduar të ndërhyhet edhe në zona të tjera që janë jashtë programit të rindërtimit, në objekte të sistemit arsimor në tërësi, të cilat janë bërë të papërdorshme aktualisht? Unë e kam ngritur edhe herë tjetër, edhe më përpara, shqetësimin për një shkollë, që është qendër komunitare në njësinë më të madhe të Bashkisë Mallakastër, Fratar, shkolla nëntëvjeçare “Gjokë Doçi”, për të cilën ka edhe projekte. Do t'i sugjeroja



ministres që të parashikohet edhe me mundësi, sepse kemi bashkuar shkollat nëntëvjeçare në shkollën e mesme, ku bëhet mësim. Ndaj, të planifikohen edhe mundësi rialokimi fondesh, por të diskutohet në projektbuxhet, në qoftë se nuk është planifikuar, pra e kërkoj sërish sot.

Në lidhje me transportin e nxënësve, jam plotësisht dakord me ato që u raportuan, por edhe më përpara kam ngritur një shqetësim, që ky shërbim publik ndaj mësuesve dhe nxënësve të mos mbetet i detyruar midis drejtorive rajonale, por, si shumë shërbime të tjera, ky shërbim t'i delegohet me përgjegjësi të drejtpërdrejtë organeve të vetëqeverisjes vendore. Për këtë do të sugjeroja që ministria të paraqesë në Kuvend një nismë ligjore, ku te ligji nr. 69/2012 "Për sistemin e arsimit parauniversitar" të bëhen shtesat dhe ndryshimet përkatëse. Aktualisht është një shërbim që ndahet për shkak të tarifave të ulëta, është vendimi i famshëm i 10 apo 12 vjetëve më parë, dhe nuk afrohen operatorët e transportit. Me këtë problem jemi ndeshur që kur ka filluar shkolla dhe bashki të ndryshme kanë ndërhyrë, sepse nuk do t'i linin nxënësit dhe mësuesit pa transport. Kështu që, më mirë t'ia japim këtë si përgjegjësi direkte.

Gjithashtu, kam një sugjerim për përjashtimin e të diplomuarve për të konkuruar për të ushtruar profesionin e nderuar të mësuesit. Unë e di që nuk janë vetëm dy ligje, ku duhet të bëhen ndryshime, por është edhe ligji "Për urdhrin profesional të mësuesit". Pra, janë tri ligje ku duhet ndërhyrë. Unë do të sugjeroja që, meqenëse ka nevojë për specialistë, të cilët janë diplomuar në shkencat natyrore, si matematikë, fizikë, kimi, edhe pse ndjekin në shumicë masterin shkencor, unë kam rast nga Fakulteti i Shkencave që një student ka mbaruar për kimi industriale dhe ka bërë master të dytë për mësuesi, të gjenden mekanizma që në zona ku ka nevojë për mësues të shkencave të vështira, të krijohet një mundësi që edhe këta të diplomuar, që kanë marrë njohuritë e thelluara në master shkencor, të ushtrojnë profesionin e tyre.

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Fjalën e ka zonja Kumbaro. Më pas zoti Nasufi.

**Mirela Kumbaro** – Shumë faleminderit, zonjës Ministre, për informacionin!

Unë dua të ndalem në dy momente.

E para është çështja e transportit. Të gjithë ne deputetët që përfaqësojmë zona me një shtrirje të madhe rurale, siç është qarku i Gjirokastrës, e kemi problemin e transportit të fëmijëve. Për shkak të shpërndarjes gjeografike, shtëpitë nuk janë në një vend që të mund ta sigurosh me një makinë, por janë të vendosura tre këtu, pesë atje, gjashtë atje.

Dua t'i kujtoj zotit Beqiraj që, në fakt, në mos gaboj, por ndoshta kolegët e Ministrisë së Arsimit mund të më korrigjojnë, në mandatin e kaluar sigurimi i transportit ka qenë tagër i bashkive. Pikërisht, ashtu siç e tha zoti Beqiraj, për shkak të tarifave të ulëta, prokurimi që

bënin bashkitë për të siguruar transportin e fëmijëve dështonte në mënyrë spektakolare rregullisht, sidomos nëpër bashki të vogla, ku praktikisht nuk ka pasur interes nga operatorët që ta siguronin. Ishte një problem i jashtëzakonshëm, ndaj prindërit e nxënësve sajoheshin me mjete rrethore. Në mos gaboj, kjo ka qenë arsyeja pse u hoq nga bashkitë dhe iu akordua zyrave arsimore. Më korrigjoni nëse e kam gabim.

Ajo që ne konstatojmë sot është që edhe kështu nuk po funksionon shpërndarja e lekëve prindërve ose mësuesve. Ndoshta kjo është për shkak të tarifës së ulët ose për shkak të mungesës së organizimit, por ajo që unë konstatoj me shqetësim është që problemi mbetet. Pra, ministria i harxhon paratë, por nuk po gjejmë mekanizmin se si ta sigurojmë transportin e fëmijëve. Unë jam futur disa herë vetë për ta bërë këtë me miq e me shokë, por kjo nuk është zgjidhje.

E dyta, për sa i përket masterit për mësuesinë, unë e kuptoj që në fushën e shkencave ekzakte ka më shumë nevojë, por nuk besoj se mund të kemi një rregull për mësuesinë për ata të shkencave ekzakte dhe një tjetër për shkencat humane. Po ashtu, unë nuk besoj se tregu ka nevojë për shkencat humane, sepse konstatoj që vazhdojmë ende të vuajmë pasojat e atyre universiteteve të tmerrshme private, që kanë prodhuar sasi të mëdha diplomash për histori, gjeografi, gjuhë dhe letërsi.

Nga informacionet e mia, më duket se ekziston mundësia që, nëse ata që kanë bërë master shkencor japin edhe lëndë psiko-pedagogjike ekstra masterit dhe plotësojnë një numër kreditesh, rreth 30, të nevojshme për mësuesinë, kjo u jep mundësinë të avancojnë drejt provimit të shtetit për mësues. E kam të saktë, apo jo? Kjo është ajo që unë kam kuptuar dhe ky është shpjegimi që unë kam dhënë në zonën time zgjedhore.

Këto ishin shqetësime dhe pyetje njëkohësisht.

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Kumbaro!

Fjalën e ka zoti Nasufi.

Nuk dëgjoheni, zoti Nasufi.

Deri sa ta rregulloni mikrofonin, fjalën e ka zoti Papa.

**Kostaq Papa** – Faleminderit, kryetar!

Së pari, dua të përshëndes ministren dhe grupin e punës për informacionin e detajuar që na dhanë për kërkesat e bëra!

Unë kam disa sugjerime për tri çështjet e rëndësishme që u prekën.

Dihet dëmi i madh që shkaktoi tërmeti në fushën e arsimit në Shqipërinë e Mesme, Tiranë, Durrës Krujë, por ajo që unë dua të shtoj në bisedën tonë në komision është kërkesa

për të nxitur përshpejtimin e ndërtimit të shkollave. Ndoshta pandemia mund të lehtësohet, ndaj duhet të krijohen hapësirat për të hyrë nxënësit në shkollat e reja. Meqë zyra ime publike është ngjitur me një shkollë që po ndërtohet afër “Harry Fultz”-it në Tiranë, shikoj që puna për ndërtimin e saj është e ngadaltë. Dua që të ketë një përshpejtim të punës. Kam përshtypjen se kjo bëhet me një grup pune nga Ministria e Arsimit, i cili të ndjek në terren përshpejtimin e ndërtimit, me korrektesë dhe konform rregullave, të shkollave të ciklit parauniversitar dhe të shkollave të tjera.

Problemi tjetër ka të bëjë me atë që preku pak edhe kolegu ynë, Ismet Beqiraj, për diplomat e mësuesisë, sidomos qarqe ku ka problematika dhe mungesa të specialistëve në fusha të caktuara, sidomos në fushat për lëndët e shkencave ekzakte, matematikë, fizikë, kimi, sidomos teknologji informacioni, që pak vite ka që ka hyrë në shkollat tona. Për shembull, marrim drejtorinë e arsimit parauniversitar në qarkun e Korçës, që mbulon një territor në distancë të madhe dhe shkolla të vogla. Kemi pranuar deri tani që një pjesë të këtyre lëndëve i japin si lëndë plotësuese edhe arsimtarë të lëndëve të tjera, por ka ardhur momenti që për përmirësimin e cilësisë, qoftë të arsimit të mesëm të ulët, qoftë të arsimit të mesëm të lartë, por edhe të shkollës fillore, duhet të kërkojmë ngritjen e cilësisë së mësuesit. Duhet të pranojmë që, nëse në këto zona këto lëndë specifike plotësohen si orare nga mësues të lëndëve të tjera, duhet të vijë momenti që të hapen këto pozicione për të hyrë në mos mësuesit e diplomuar në mësuesi në këto lëndë, të paktën specialistët e masterëve, që të plotësohet kuadri, të ndryshohet ligji, që nxënësit të marrin mësim nga specialistët.

Nëse nuk arrin të plotësohet me mësues që kanë mbaruar fushën e mësuesisë apo masterin e mësuesisë për këto lëndë, të plotësohet me ata, sepse janë kompetentë për shkencën për të cilën kanë studiuar. Të mos e japë lëndën e IT-së mësuesi i fizikulturës apo mësuesi i historisë, sepse njeh kompjuterin.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Papa!

Fjalën e ka zoti Nasufi!

**Fadil Nasufi** – Faleminderit!

E përshëndes zonjën Kushi për parashtrimin e të gjitha problematikave për të cilat është ftuar sot në komision! Kam biseduar me të para dhjetë ditëve, kur ishte në Berat, për sfidat dhe kërkesat që ka niveli i arsimit parauniversitar në Berat, prandaj s’po ndalem në këtë pikë.

Dua ta përshëndes për të gjitha arritjet dhe ndjekjen hap pas hapi të programit të rindërtimit për shkollat! Ndaj mendimin që po bëhet një transformim rrënjësor i infrastrukturës arsimore dhe po ndërtohen shkolla model, të cilat po sfidojnë edhe godinat që janë ndërtuar para ... *(nuk dëgjohet)*, pa folur për të gjithë trashëgiminë e godinave që kanë të meta

arkitekturore, por më shumë funksionale, që nuk kanë qasje fare me programet e sotme të shkollave. Pra, ne mirëpresim që shkolla të këtij standardi të ndërtohen edhe në bashkitë tona.

Së dyti, dua të them që ne, duke pasur njerëz kaq kompetentë, të ditur, të urtë, kemi edhe një prerje që ai që punon është modest në atë që thotë, kërkoj nga zonja ministre dhe nga të gjitha institucionet e arsimit të bëjnë më shumë promovim për këtë punë madhështore që po bëhet, sepse, edhe për shkak të afrimit të fushatës elektorale, por edhe për shkak të qasjes negative që kanë kundërshtarët tanë politikë, mundohen ta errësojnë të gjithë këtë punë madhështore që po bëhet.

Sot në Berat qarkullojnë dy lajme: lajmi i parë është ai i Presidentit të Republikës, i cili të gjitha investimet që po bën qeveria në Berat për infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, transformimin rrënjësor të qytetit, i quan shkatërrim urban. Pret në Presidencë njerëz nihilistë, që nuk i kanë dhënë asgjë kësaj shoqërie dhe i mbarsur me negativitet dhe nihilizëm, arrin deri atje sa thotë “unë jam në krah të qytetarëve të Beratit për të ndalur shkatërrimin”. Çfarë shkatërrimi, zotëri, kur gjatë qeverisjes së Ramës Berati ka filluar të marrë frymë nëpërmjet shumë projekteve zhvillimore të munguara ndër vite?!

Sot u prish shkolla e Mangalemit, një shëmti arkitekturore, që ishte një perde izoluese e Mangalemit dhe i gjithë qyteti duket sikur merr frymë nga mushkëritë e veta, kur shikon këtë pamje magjike të Mangalemit, sepse është zbatim i rekomandimeve të UNESCO-s për t’i hequr objektet që bien ndesh me vlerat arkitekturore të qytetit të Beratit.

Për arsimin ka shumë për të folur dhe ne deputetët kemi shumë për të thënë për mënyrën si e morëm, për transformimet që kemi bërë, për reformat që kemi kryer, por duhet të jemi krenarë që po bëjmë gjënë e duhur në kushte shumë të vështira.

Dua ta përshëndes ministren Kushi! U bashkohem vërejtjeve që ngritën kolegët, Kumbaro, Ismeti dhe Papa në lidhje me kërkesat që kanë dalë për rregullimet midis bashkisë dhe Ministrisë së Arsimit. Padyshim që kemi kërkesa në komunitetet tona për investime në arsim, por së bashku ne duhet ta pohojmë gjënë e mirë që kemi bërë, sepse krenohemi me këtë. Shkollat e ndërtuara janë një sfidë e madhe, sfidojnë edhe objektet që kanë bërë privatët, janë në akord të plotë me gjithçka moderne që zhvillohet sot dhe këtë ne duhet ta përshëndesim.

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Nasufi.

Fjalën e ka zonjën Almira.

**Almira Xhembulla** – Faleminderit, kryetar!

Pa dashur të bie në përsëritje, unë dua ta falenderoj ministren dhe të gjithë stafin e ministrisë për punën heroike, sepse të gjithë sfidës së madhe të situatës pas tërmetit, iu

bashkëngjit edhe pandemia! Një “bravo” për të gjithë mënyrën se si arritën të mbajnë gjithë procesin e mësimdhënies në një kapacitet të shkëlqyer. Pavarësisht sfidave dhe të gjitha gojëve të liga, unë mendoj që është bërë një punë jashtëzakonisht kolosale për sa i takon kësaj gjëje.

Në fakt, unë kam diskutuar personalisht me ministren. Pavarësisht se qarku i Dibrës nuk është një qark që futet te territori i vendeve që kanë pasur probleme të drejtpërdrejta me tërmetin, ne kemi pasur një shkollë të dëmtuar në bashkinë e Klosit, njësi administrative e Suçit. Dua ta risjell edhe një herë në vëmendjen e ministres dhe të stafit për ta marrë në konsideratë në parashikimet buxhetore, sepse shkollë e mesme e bashkuar “Haxhi Lata” ka një numër nxënësish që janë transferuar. Mirë është që të merret në konsideratë shqetësimi që kam përcjellë unë, por patjetër i kryetarit të bashkisë dhe i gjithë komunikimit zinxhir që është bërë.

Shkollat vazhdojnë të ndërtohen edhe në zona që nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me tërmetin. Për shembull, në fshatin Kërçisht, njësi administrative Maqellarë, është në përfundim një shkollë e re që po ndërtohet sipas të gjitha standardeve. Ashtu siç e tha Fadili, edhe pse po përpiqen shumë që në një farë mënyre ta zbehin apo ta zhbëjnë të gjithë këtë përpjekje maksimale, çdo gjë është në rregull, puna po ecën, ne e kemi vetëm me veten tonë konkurrencën dhe sfida jonë është që të bëjmë më të mirën për qytetarët.

Faleminderit stafit të ministrisë dhe ministres për prezantimin jashtëzakonisht të qartë dhe shterues!

Punë të mbarë!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Almira!

Fjalën e ka zonja Rista.

**Adelina Rista** – Faleminderit, kryetar!

Përsëritje të gjithëve!

Edhe unë fjalën time dua ta nis me një urim për ministren e Arsimit dhe të gjithë stafin e saj për punën plot përkushtim, përgjegjshmëri dhe ndjenjën e lartë të përgjegjësisë në këtë situatë të vështirë pandemie, posttërmet, për të kurorëzuar me sukses vitin mësimor, që ishte një vit i pazakontë, i diktuar nga ajo situatë e pazakontë.

Ju uroj suksese dhe ju përsërites për punën plot përkushtim!

Kujtoj se tërmeti pati dëmet e tij, si në të gjithë Republikën, edhe në Fier, ku unë banoj, pikërisht në zonën që mbuloj si deputete në Darzezë, ku shkolla u rrënuar plotësisht dhe u ndërtua e re nga themelet në një kohë rekord. Pra, për këtë dua të them një faleminderit të madhe edhe në emër të atij komuniteti, të cilit shkolla iu ndërtua e re në të njëjtin vend dhe nga themelet. Ritheksoj se kjo tregon ndjenjën e lartë, përgjegjësinë dhe përkushtimin që t'i realizojmë detyrat e ngarkuara, ashtu siç duhet. Kuptohet që situata është e pazakontë, kuptohet

që puna është shumëfish më e madhe dhe kuptohet se ne të gjithë i sfidojmë të gjitha pasojat e tërmetit për ta minimizuar sa më parë dhe me sukses çdo dëm të tij, si dhe dëmet që ai ka shkaktuar edhe në infrastrukturën shkollore, duke qenë dhe në kushtet e pandemisë. Kuptohet që viti mësimor është, në bazë të rregullave që janë vendosur nga pandemia, jo i zakonshëm dhe unë dua të bëj një pyetje. Janë disa shkolla të veçanta, siç janë shkollat me profil artistik, a ndihet mungesa e mësuesve të sëmurë nga pandemia, pra a ndihet mungesa te nxënësit e mësuesve që janë për lëndë specifike? A bëjnë pushime nxënësit në këto shkolla, sepse kanë mungesë mësuesish apo mbulohen?

Faleminderit! Suksese ministres dhe stafit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Rista!

Fjalën e ka zonja Ministre!

Zonja Ministre, mund t'iu përgjigjeni 2-3 pyetjeve që bënë anëtarët e komisionit.

**Evis Kushi** – Ju falënderoj të gjithëve për fjalët inkurajuese, por sidomos për shqetësimet që ngritët, për kërkesat dhe për sugjerimet! Natyrisht, të gjitha janë të drejta dhe patjetër i kemi mbajtur shënim dhe do t'i kemi në konsideratë gjatë punës sonë në vazhdim.

Për sa u takon atyre 2-3 pyetjeve apo problematikave konkrete që mund të diskutojmë, së pari, zoti Beqiraj ngriti një pyetje nëse do të ketë ndërhyrje të tjera në objektet tona arsimore, përveç objekteve të procesit të rindërtimit. Është e vërtetë që ne e kemi diskutuar këtë çështje edhe gjatë prezantimit të buxhetit për vitin 2021 dhe në buxhet ka një fond të parashikuar për ndërtime të reja, për rikonstruksione apo për shtesa në objektet ekzistuese arsimore edhe në qarqe të tjera. Pra, përveç qarqeve Tiranë, Durrës dhe Lezhë, që janë tri qarqet ku po aplikohet procesi i rindërtimit dhe ku po rindërtohen, siç e thamë, 167 objekte arsimore, ne në buxhetin e vitit 2021 parashikojmë rreth 100 apo 120 objekte të reja arsimore. Pra, nënkuptoj objekte të reja ose rikonstruksione të objekteve ekzistuese.

Megjenëse zoti Beqiraj, por edhe deputetët e tjerë ngritën problematika specifike për shkolla konkrete në zonat e tyre elektorale, kjo është një përgjigje që nuk mund t'jua jap në këtë moment, sepse procedurat janë të tilla që ministria shpall thirrjen dhe më pas janë bashkitë që aplikojnë me projekte dhe më pas nëpërmjet komisioneve të ndryshme bëhet renditja, vlerësimi, pikëzimi dhe më pas përzgjedhja e shkollave që do të përfshihen për të përfitur nga ky buxhet. Kështu që nuk mund t'jua jap tani këtë përgjigje, por është e rëndësishme që në të gjithë territorin Shqipërisë, në të gjitha bashkitë, përtej 3 bashkive, që janë zona të dëmtuara nga tërmeti, ne do të kemi 100 apo 120 shkolla që do të përfitojnë ndërtime të reja apo rikonstruksione të godinave ekzistuese. Në total parashikohet të përfitojnë rreth 40 mijë nxënës dhe 4 mijë mësues dhe edukatorë.

Për sa i përket shqetësimit apo kërkesës së zotit Papa në lidhje me përsheptimin e punimeve për ndërtimin apo rindërtimin e këtyre objekteve arsimore, në fakt, që nga Kryeministri, unë, ministri për Rindërtimin, shumë kolegë dhe shumë institucione të tjera jemi pothuajse çdo ditë në terren për të inspektuar dhe për të ndjekur vijueshmërinë e punimeve në këto objekte. Unë dua t'ju garantoj se puna jo vetëm që po ecën me ritme shumë të shpejta, shumë më të shpejta se sa në kushte normale, madje në shumë raste punohet me dy apo tri turne. Ne kemi objekte arsimore, të cilat sot janë ndërtuar dhe nxënësit zhvillojnë mësimin në kushte normale dhe puna atje ka zgjatur, pra shkollat janë ndërtuar për 3, 4 apo 5 muaj, ndërkohë që në pjesën më të madhe të këtyre objekteve koha mesatare ka qenë rreth 6 muaj. Të mendosh që standardet janë ndër më të mirat, ashtu siç e përmenda pak më parë duke u krahasuar me të gjitha standardet më të mira të Bashkimit Europian, mendoj se puna po ecën me ritme shumë të shpejta dhe shkollat po bëhen sipas motos sonë: *building that better*, pra me kushte shumë të mira, më të forta, më të sigurta dhe ndoshta edhe më të mira se shumë shkolla të tjera në rajon.

Për sa i përket çështjes së masterit për të gjithë ata që dëshirojnë të japin provimin e licencës, pra për të gjithë ata që duan të bëhen mësues, edhe pse kanë kryer studimet në një master që nuk është në mësuesi, por që është në një fushë të caktuar apo në një shkencë të caktuar, e thashë edhe pak më parë që është shumë e rëndësishme për ne dhe është e detyrueshme, bazuar në legjislacionin në fuqi, që lëndët e formimit psiko-pedagogjik janë shumë të rëndësishme për formimin e një mësuesi. Pra, nuk mund të bëhet një individ, një shtetas, që mund të ketë njohuri shumë të mira në fizikë, në kimi dhe në çdo fushë tjetër, por, nëse ai nuk ka marrë gjatë formimit të tij lëndë të formimit psiko-pedagogjik, nuk mund të jetë një mësues i mirë. Për këtë arsye, ashtu siç e tha edhe zonja Kumbaro, ekziston mundësia për ata, që kanë bërë master në një fushë tjetër, të bëjnë një master në mësuesi dhe avantazhi është që të gjitha ato lëndë të fushës përkatëse mund t'u njihen dhe u mbeten vetëm kreditet e fushës së mësuesisë, pra u njihen, por është e rëndësishme që ata të regjistrohen në masterin për mësuesi dhe mund të përfitojnë që të mos i japin edhe një herë nga e para lëndët që ata tashmë i kanë dhënë në masterin e parë. Por formimi psiko-pedagogjik është shumë i rëndësishëm për një mësues, sidomos për ne që po i japim kaq shumë rëndësi rritjes së cilësisë së mësuesve. Ne vitin 2018 e kemi quajtur viti i mësuesisë, dhe kjo është pasur nga një sërë reformash dhe masash për ta rritur cilësinë e mësuesve, sigurisht që nuk mund të çdojmë në këtë aspekt.

Së pari, është ligji dhe e dyta, është vizioni ynë që mësuesit tanë të kenë një cilësi sa më të lartë dhe të ofrojmë standardet më të mira në shkollat tona.

Nuk e di nëse ka ngelur ndonjë çështje tjetër.

Për sa u takon shkollave artistike, zonja Rista ngriti një shqetësim në lidhje me mungesat që mund të krijohen për shkak të situatës së pandemisë jo vetëm në shkollat artistike, por në të gjitha shkollat. Ne, me një vendim të Këshillit të Ministrave, që në fillim të këtij viti shkollor kemi miratuar 1 mijë mësues shtesë në sistem. Domethënë, në rastin më të parë që konstatohet një mësues me COVID dhe karantinohet, menjëherë reagon shkolla, bën kërkesë dhe më pas zyra arsimore dhe drejtoria rajonale marrin masa për zëvendësimin e këtij mësuesi me një mësues tjetër përsëri nga portali “Mësues për Shqipërinë”. Në përgjithësi nuk ka pasur vonesa, mund të ketë pasur vonesa një ditë ose maksimumi 2 ditë, sepse na kanë ardhur në ndihmë edhe mësuesit praktikantë, të cilët po japin një kontribut shumë të rëndësishëm, por në përgjithësi zëvendësimet janë bërë në një kohë shumë të shpejtë. Kohët e fundit kemi pasur raste kur shkollat mund të kenë kaluar në sistemin *online* për një ditë, dy ditë apo disa ditë, kur numri i mësuesve të infektuar ka qenë i lartë, por në përgjithësi mësimi po vijon normalisht në të gjitha shkollat tona, sipas skenarit të kombinuar me një pjesë të tyre, por edhe sipas skenarit të parë në ato shkolla në zonat periferike, ku situata e pandemisë është më e qetë dhe ku hapësirat janë të tilla që mund të zhvillohet mësimi edhe në skenarin e parë, pra të gjithë nxënësit me turne me prezencë fizike. Ndërsa në qendrat e mëdha të qyteteve, në shkollat e mëdha, ku numri i nxënësve është i madh dhe ku situata e pandemisë është më e rënduar, natyrisht që po aplikohet sistemi i kombinuar apo skenari i kombinuar që gjysmën e javës nxënësit janë me prezencë fizike në shkollë, ndërsa në gjysmën e javës janë në shtëpi, duke zhvilluar mësimin *online*.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Ministre!

Ju falënderojmë për informacionin!

**Ismet Beqiraj** – Zoti kryetar, ju lutem!

**Ramazan Gjuzi** – Urdhëroni, zoti Beqiraj!

**Ismet Beqiraj** – Në fakt, unë ngrita një shqetësim, i cili ishte edhe pyetje. A ka nismë ligjore ose akte nënligjore në lidhje me delegimin e përgjegjësisë së transportit organeve të qeverisjes vendore, ose një nismë për një akt nënligjor për ndryshimin e VKM-së nr. 682 të vitit 2015, sepse nuk është komform me tregun transporti në zona të vështira?

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Urdhëroni, zonja Ministre!

**Evis Kushi** – Ashtu siç e thashë pak më parë, ne jemi vazhdimisht në komunikim edhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por edhe me bashkitë për zgjidhjen e këtij problemi, por ende nuk kemi një iniciativë të tillë, siç e



sugjeron zoti Beqiraj. Domethënë, jemi përpjekur me mënyra alternative të ndryshme që t'i diskutojmë së bashku, por një iniciativë të tillë nuk e kemi ende.

Faleminderit për sugjerimin dhe do ta kemi në konsideratë gjatë diskutimeve në vazhdim!

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Ministre, për informacionet e detajuara që na dhatë për të tria çështjet!

Ju uroj punë të mbarë në këtë kohë të vështirë pandemie!

Faleminderit dhe ditën e mirë bashkë me drejtoreshën dhe zotin Todaj!

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**